dt. 11.01.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT BERAT

SEKTORI JURIDIK

Nr. 01/ Prot. Datë 11.01.2023

Lënda: Për verifikim të ligjshmërisë së akteve.

BASHKIA POLIÇAN

Në mbështetje të Ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, pasi verifikova bazueshmërinë ligjore të akteve, shprehem:

- Konfirmoj Vendimin nr.53 datë 23.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Per miratimin e buxhetit te vitit 2023 dhe programi buxhetor afatmesem 2023-2025"
- Konfirmoj Vendimin nr.54 datë 23.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Per miratimin e nivelit te Taksave-Tarifave Vendore dhe administrimi i tyre per vitin 2023"
- Konfirmoj Vendimin nr.55 datë 23.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Për miratimin e numrit te pergjithshem te punonjesve te Bashkise Poliçan,Njesive Administrative dhe institucioneve ne varesi te Bashkise per vitin 2023"
- Konfirmoj Vendimin nr.56 datë 23.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Për miratimin e nivelit te pagave te punonjesve te Bashkise Poliçan,Njesive Administrative dhe institucioneve ne varesi te Bashkise per vitin 2023"
- Konfirmoj Vendimin nr.57 datë 23.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Për miratimin e bursave per nxenesit e Arsimit Parauniversitar, per vitin shkollor 2022-2023"
- Konfirmoj Vendimin nr.58 datë 23.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Për miratimin e Planit te Aktiviteteve te Keshillit Bashkiak Poliçan, per periudhen Janar-Dhjetor 2023"
- Konfirmoj Vendimin nr.59 datë 23.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Poliçan me objekt: "Për miratimin e Planit Vendor te Menaxhimit te Integruar te Mbetjeve Urbane dhe Rregullores per Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve te Bashkise Poliçan"

PREFEKTI I QARKUT
Valbona Zylyftari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT BERAT

Punoi:M.Kurti

Adresa : Lagja "28 Nentori" email: prefekti.berat@mb.gov.al Tel/Fax: 032 2 34141

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË POLIÇAN

VENDIM

Nr.59, datë ___.12.2022

"Për Miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe Rregullores për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Poliçan"

Këshilli i Bashkisë Poliçan, i mbledhur sot më datë 23.12.2022 bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22/09/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 12 dhe neni 13, Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligjin nr. 8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", VKM nr. 418/2020, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035", VKM nr. 671/2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", në funksion dhe në përmbushje të kuadrit ligjor mjedisor, VKM nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr. 608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr. 319, datë 31.05.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve", VKM nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve", VKM nr. 957 datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", VKM nr. 452, datë 11.07.2012, ndryshuar me VKM nr. 389, datë 27.6.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave", VKM nr. 575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" dhe në Vendimin e KKT nr. 1, Datë 13.01.2020 " Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta", pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike;

VENDOSI

1. **Të miratojë Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Poliçan për periudhën 2022-2027.**
2. **Të miratojë Rregulloren për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.**
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Shërbimeve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55, pika 6
5. **Vendimi u miratua me 12 pro, — vota kundër.**

KRYETARE E KËSHILLIT
Mimoza Lulaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POLIÇAN

Nr.3042/1 Prot.

Date, 28.12.2021

PROJEKT

Plani Vendor

i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

i Bashkisë Poliçan

2022–2027

Pasqyra

0 Parathënie 7

1 Konteksti kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve (MIM) 8

1.1 Vëzhgim i përgjithshëm dhe vlerësimi i BE për progresin 8

1.2 Korniza ligjore dhe e politikave 8

1.2.1 Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit 8

1.2.2 Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032 10

1.2.3 Ligje dhe akte të tjera nënligjore 11

1.3 Rolet dhe përgjegjësia në nivelin kombëtar, rajonal dhe vendor 16

1.3.1 Niveli kombëtar 16

1.3.2 Niveli rajonal 16

1.3.3 Niveli vendor 17

2 Konteksti vendor për menaxhimin e mbetjeve të ngurta 18

2.1 Profili i Bashkisë 18

2.2 Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në bashki 23

2.3 Sasitë e mbetjeve, burimet dhe karakteristikat 24

2.4 Shërbimet aktuale të menaxhimit të mbetjeve 26

2.4.1 Pastrimi i rrugëve 26

2.4.2 Grumbullimi i mbetjeve dhe transporti 26

2.4.3 Depozitimi i mbetjeve 28

2.5 Ekonomia dhe financimi i menaxhimit aktual të mbetjeve 31

2.6 Analizimi i tregut të riciklimit 32

2.7 Vlerësimi i gjendjes aktuale të menaxhimit të mbetjeve 33

3 Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve 34

3.1 Fushëveprimi i Planit Vendor 34

3.2 Të dhënat ku bazohet planifikimi 34

3.2.1 Parashikimi i popullsisë 34

3.2.2 Parashikimi i sasisë së mbetjeve 35

3.3 Kuadri strategjik 37
3.3.1 Shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve 39
3.3.1.1 Objektivi specifik 1.1: Shtrirja e shërbimit të MIM në territorin e bashkisë 39
3.3.1.2 Objektivi specifik 1.2: Ngritja e sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve 43
3.3.1.3 Objektivi specifik 1.3: Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të ricikluesshme të thata 48
3.3.1.4 Objektivi specifik 1.4: Grumbullimi i diferencuar dhe kompostimi i mbetjeve bio 50
3.3.1.5 Objektivi specifik 1.5: Pastrimi me cilësi i rrugëve dhe shesheve 51
3.3.1.6 Objektivi specifik 1.6: Menaxhimi i integruar mjedisor i mbetjeve inerte 52
3.3.1.7 Objektivi specifik 1.7: Menaxhimi i rrymave specifike të mbetjeve 53
3.3.1.8 Objektivi specifik 1.8: Rehabilitimi i vend depozitimit bashkiak 53
3.3.1.9 Objektivi specifik 1.9: Mbyllja e sigurt dhe me standard e vend depozitimeve të vjetra 55
3.3.2 Zhvillimi organizativ dhe fuqizimi i kapaciteteve 55
3.3.2.1 Objektivi specifik 2.1: Ngritja dhe funksionimi i strukturës bashkiake për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve efektive për MIM 56
3.3.2.2 Objektivi specifik 2.2: Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve të bashkisë në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve 56
3.3.2.3 Objektivi specifik 2.3: Miratimi i kuadrit rregullator për MIM në Bashkinë Poliçan 57
3.3.2.4 Objektivi specifik 2.4: Dokumentimi, menaxhimi dhe raportimi i saktë i të dhënave për mbetjet bashkiake për të mundësuar politikëbërje mbi bazë evidencash dhe monitorim efikas të shërbimit 57
3.3.3 Qendrueshmëria financiare e shërbimeve të MIM 58
3.3.3.1 Objektivi specifik 3.1: Mbulimi i kostove të shërbimit MIM nga tarifat 59
3.3.3.2 Objektivi specifik 3.2: Ngritja e një sistemi efiçent dhe transparent për mbledhjen e tarifave 59

3.3.4 Informimi, pjesëmarrja dhe ndërgjegjësimi i publikut.....60

3.3.4.1 Objektivi specifik 4.1: Informimi dhe edukimi i qytetarëve 60

3.3.4.2 Objektivi specifik 4.2: Rritja e angazhimit të qytetarëve në aktivitetet e mbajtjes pastër të bashkisë 61

3.3.4.3 Objektivi specifik 4.3: Pjesëmarrja e publikut në proceset e vendimmarrjes lidhur me MIM 61

3.3.5 Shmangia dhe reduktimi i mbetjeve.....62

3.3.5.1 Objektivi specifik 5.1: Kompostimi i mbetjeve të biodegradueshme brenda oborreve në zonat rurale 62

3.3.5.2 Objektivi specifik 5.2: Parandalimi i mbetjeve nëpërmjet ripërdorimit.....64

4 Plani i Veprimit, treguesit matës dhe përllogaritjet e kostove 66

5 Monitorimi 83

5.1 Dokumentimi dhe raportimi 83

5.2 Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit 83

Lista e tabelave

Tabela 1 Ligje për menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake 11

Tabela 2 Akte nënligjore për menaxhimin e mbetjeve 12

Tabela 3 Populllsia (2021) sipas të dhënave të kryetarëve të fshatrave.....21

Tabela 4 Familjet që trajtohen me Ndihmë Ekonomike sipas Njësive Administrative.....23

Tabela 5 Personat me aftësi ndryshe sipas kategorive në Bashkinë Poliçan.....23

Tabela 6 Të dhënat për sasitë e mbetjeve sipas Planit Sektorial MIM 24

Tabela 7 Parashikimi i popullsisë në Bashkinë Poliçan për periudhën 2022–2042 35

Tabela 8 Sasitë specifike të gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit.....36

Tabela 9 Parashikimi i sasisë së mbetjeve që do të gjenerohen në Bashkinë Poliçan.....36

Tabela 10 Itinerari i propozuar për grumbullimin e mbetjeve në zonën e re.....42

Tabela 11 Plani i Veprimit gjatë periudhës së planifikuar 2022–2027 66

Tabela 12 Treguesit matës për arritjen e objektivave të Planit.....73

Tabela 13 Kostot e parashikuara për realizimin e masave të Planit.....76

Lista e figurave

Figura 1 Krahasimi i objektivave dhe synimeve të shënjestruara për MMN 15

Figura 2 Harta e territorit të Bashkisë Poliçan sipas zonave 19

Figura 3 Pamje nga Parku Kombëtar i Malit të Tomorrit 20

Figura 4 Struktura organizative e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.....23

Figura 5 Përbërja e mbetjeve në Qarkun e Beratit.....25

Figura 6 Përbërja e mbetjeve në qytet dhe zonat rurale të Bashkisë Poliçan.....25

Figura 7 Planvendosje e vend depozitimit të mbetjeve urbane 29

Figura 8 Vend depozitimi aktual i mbetjeve urbane 29

Figura 9 Planvendosja e vend depozitimit të mbetjeve inerte 30

Figura 10 Vend depozitime të identifikuara nga studimi i MTM (Raporti final, 2018).....30

Figura 11 Parashikimi i popullsisë të Bashkisë Poliçan 35

Figura 12 Harta e zgjerimit të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale 40

Figura 13 Harta nga Google të rrugëve hyrëse për në Peshtan, Kapinovë dhe Tozhar 43

Figura 14 Vendndodhja e propozuar për stacion transferimi.....44

Figura 15 Planimetria e përgjithshme e stacionit të transferimit të propozuar 46

Figura 16 Koncepti teknik për stacionin e transferimit.....46

Figura 17 Vend depozitimi aktual i mbetjeve urbane 54

Figura 18 Vend depozitimi i vjetër i mbetjeve pranë përroit të Plirzës.....55

0 Parathënie

Ky dokument paraqet Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) të Bashkisë Poliçan, një dokument strategjik për zbatimin e politikave dhe legjislacionit kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivel lokal. Plani është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (SKMIM), Planin Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve të Qarkut Berat dhe në përputhje me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta" të amenduar, Udhëzimin nr. 6 datë 27.11.2007 i Ministrisë së Mjedisit, si dhe legjislacionin tjetër për mbetjet. Sipas kërkesave ligjore, ky plan përmban objektiva specifikë për parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve, reduktimin e rrezikut të tyre, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e tyre me metoda ekonomikisht të përballueshme dhe ekologjikisht të pranueshme pa dëmtuar shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, financimin e qendrueshëm të masave, monitorimin dhe këmbimin e informacionit, bashkëpunimin ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe me sektorin privat.

PVMIM përshkruan infrastrukturën e kërkuar teknike dhe institucionale, përcakton masat dhe veprimet praktike për menaxhimin, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe cakton përgjegjësitë tek aktorë të ndryshëm bazuar në analizën e gjendjes aktuale

PVMM shtrihet për një periudhë pesëvjeçare (2022–2027). Përgatitja e planit u mbështet nga "Projekti për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta në Qarkun e Beratit, Shqipëri, Faza e ndërmjetme". Projekti financohet nga Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO, i Konfederatës Zvicerane me një kontribut granti prej 2.75 milionë franga. Ky projekt kontribuon në përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në Qarkun e Beratit dhe reduktimin e ndikimeve negative në mjedis. Ai trajton nevojat e emergjente të rehabilitimit të menjëhershëm dhe shtron bazën për investimet e ardhshme në infrastrukturën rajonale.

1 Konteksti kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve (MIM)

1.1 Vëzhgim i përgjithshëm dhe vlerësimi i BE për progresin

Me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në 2006, Shqipëria ka shprehur synimet për integrimin në BE dhe vendos objektiva afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për qëndrueshmërinë mjedisore të vendit. Zotimet e marra në kuadër të marrëveshjes janë parashtruar edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014-2020 dhe Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve. Arritja e këtyre objektivave dhe progresi i arritur pasqyrohet nëpërmjet raporteve vjetore të BE për Shqipërinë. Në raportin më të fundit për vitin 2021, përfshihet vlerësimi si më poshtë: *"Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve është përafruar pjesërisht. Mbyllja e shumë vend depozitimeve dhe vendgrumbullimeve që nuk plotësojnë kushtet mbetet një sfidë. Grumbullimi i diferencuar i rrymave të mbetjeve dhe instrumentët ekonomikë për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara. Ndërtimi i një incineratori të ri përveç dy të tjerëve ekzistues në Elbasan dhe Fier paraqet shqetësim në rritje sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin e BE për mbetjet, përfshirë parimin e hierarkisë së mbetjeve dhe synimet për normat e riciklimit. Shqipëria duhet të promovojë ekonominë qarkulluese dhe të krijojë incentiva për parandalimin, pakësimin dhe riciklimin e mbetjeve për të ulur sasitë e mbetjeve që depozitohen. Zbatimi i legjislacionit për rrymat e mbetjeve duhet të përshpejtohet. Duhet të qartësohet dhe të forcohet me burime njerëzore dhe buxhet roli i institucioneve për zbatimin dhe kontrollin e pajtueshmërisë."*

1.2 Korniza ligjore dhe e politikave

Legjislacioni shqiptar për menaxhimin e mbetjeve është përmirësuar nëpërmjet transpozimit të direktivave të BE në legjislacionin e vendit. Gjatë viteve të fundit vendi ka përparuar ndjeshëm në këtë drejtim. Kuadri ligjor është forcuar dhe është përmirësuar bashkërendimi i politikave në nivel qendror.

1.2.1 Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit

Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2020–2035 (miratuar me VKM 418/2020) është hartuar me vizionin e "krijimit të një kuadri strategjik dhe rregullator në Shqipëri, për të ulur sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhuar në mënyrë të integruar mbetjet e gjeneruara në linjë me objektivat e Direktivës Kuadër të Mbetjeve të BE dhe marrëveshjet ndërkombëtare".

Qëllimet strategjike të tij janë:

1. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit;

2. Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve;

3. Financimi i qendrueshëm i menaxhimit të mbetjeve;

4. Burimet njerëzore, rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve.

Në Strategji përcaktohen standardet minimale për menaxhimin e rrymave të mbetjeve bashkiake:

Prioritet 1

- 100% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat urbane
- Mbetjet të depozitohen në një vend depozitim të autorizuar dhe të kontrolluar

Prioritet 2

- 90% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale

Prioritet 3

- Ndarja e mbetjeve për të vijuar më tej me riciklimin

Parimet bazë për menaxhimin e mbetjeve përmblidhen si më poshtë:

1. ***Hierarkia e mbetjeve*** – parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve, sipas qëllimit se çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe kalimin drejt ekonomisë qarkulluese. Përparësi i jepet parandalimit të mbetjeve, duke synuar mbajtjen sa më gjatë si produkte. Në rastet kur produkti shndërrohet në mbetje, përparësia i jepet ripërdorimit, më pas riciklimit, më tej rikuperimit dhe në fund depozitimit.

2. ***Ndotësi paguan*** – lidhet me kostot e ndotjes që duhet të ngarkohen te ndotësit dhe te konsumatorët përgjegjës për të.

3. ***Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit*** – është përgjegjësia që duhet të ketë një prodhues apo importues gjatë gjithë ciklit të jetës së produkteve, që prej krijimit deri në shkallën e postkonsumit. Përparësi i duhet dhënë ndarjes së diferencuar të produkteve dhe të materialeve

që paraqesin një rrezik më të lartë ndaj mjedisit dhe/ose për ato produkte që ka treg përpunimi për qëllime riciklimi ose rikuperimi.

4. ***Parandalimi i rrezikut mjedisor*** – nënkupton që kur ka të dhëna mbi praninë e rrezikut mjedisor, duhen marrë masa të përshtatshme parandaluese.

5. ***Integrimi*** – mbrojtja e mjedisit duhet të jetë pjesë integrale e çdo procesi të zhvillimit të politikave.

6. ***Përgjegjësia e ndërsjellë*** – të gjithë aktorët e përfshirë në gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve duhet të jenë përgjegjës dhe duhet të bashkëpunojnë për të arritur objektivat e Strategjisë.

7. ***Parimi i vetëmjaftueshmërisë*** – nënkupton që vendi duhet të zhvillojë një rrjet pajisjesh dhe impiantesh të integruara dhe të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve.

8. ***Parimi i afërsisë*** – mbetjet duhet të depozitohen ose të rikuperohen në impiantet më të afërta dhe sa më afër vendit të gjenerimit të mbetjeve.

9. ***Përballueshmëria financiare*** – niveli i tarifës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve duhet të jetë i përballueshëm dhe i pranuar nga komuniteti.

10. ***E drejta për informim dhe pjesëmarrje*** – çdo qytetar ka të drejtë të marrë informacion rreth menaxhimit të mbetjeve lehtësisht nga të gjitha institucionet përgjegjëse. E drejta për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje nënkupton që publikut duhet të jetë i informuar për të gjitha projektet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe duhet t'i jepet mundësia të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.

11. ***Zbatimi i praktikave më të mira*** – për të eleminuar mangësitë, për të siguruar kontrollin dhe zbatimin e standardeve evropiane.

1.2.2 Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032, i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1 datë 13.01.2020 përfaqëson nivelin e dytë të planifikimit për menaxhimin e mbetjeve. Në të prezantohet koncepti i Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve dhe rajonalizimi si një instrument për të mundësuar zbatimin e teknologjive të avancuara duke zbatuar ekonominë e shkallës. Bashkia Poliçan bën pjesë në ZMM Berat, e cila përkon me kufijtë administrativë të Qarkut të Beratit.

1.2.3 Ligje dhe akte të tjera nënligjore

Në tabelën në vijim paraqiten ligjet dhe aktet nënligjore shqiptare me rëndësi të veçantë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake.

Tabela 1 Ligje për menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake

Ligji Nr./Viti	Përmbajtja	Ndryshimet ligjore Nr./viti
10463/2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve	156/2013 32/2013 28/2022
10431/2011	Për mbrojtjen e mjedisit	
68/2017	Për financat e vetëqeverisjes vendore	
139/2015	Për vetëqeverisjen vendore	
115/2014	Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë	
107/2014	Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit	73/2015 28/2017 42/2019 119/2020
125/2013	Për koncesionet dhe partneritetin publik privat	77/2015 50/2019
10448/2011	Për lejet e mjedisit	44/2013
10440/2011	Per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	
8094/1996	Për largimin publik te mbetjeve	
10433/2011	Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë	

Tabela 2 Akte nënligjore për menaxhimin e mbetjeve

VKM Nr./Viti	Përmbajtja	Ndryshimet VKM Nr./viti
452/2012	Për lendfillet e mbetjeve	389/2018: Standartet per rehabilitimin dhe operimin e vend depozitimeve
319/2018	Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve	
608/2014	Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre	
418/2014	Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim	
957/2012	Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike	
866/2012	Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre	
765/2012	Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura	
705/2012	Për menaxhimin e mbetjeve nga automjetet në fund të jetës	
452/2012	Per lendfillet e mbetjeve	
178/2012	Për incinerimin e mbetjeve	
177/2012	Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre	VKM Nr. 232, date 26.4.2018
333/2011	Për administrimin e vend depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane	
798/2010	Për miratimin e Rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore	
402/ 2021	Për miratimin e Katalogut të mbetjeve	

Udhëzime

- “Për kriteret e studimit të projekteve për mbylljen dhe rindërtimin e vend depozitimeve për mbetjet e ngurta urbane” (Udhëzim nr. 1250, datë 23.02.2009 dhe nr. 406/1, datë 03.03.2009, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit)
- “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta” (Udhëzim nr. 6, datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave)

Rregullore

- “Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre” (Rregullore nr. 1, datë 30.03.2007, e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit)
- “Rregullore higjieno-sanitare për pastrimin në zonat urbane dhe rurale, për administrimin dhe trajtimin e mbeturinave” (Rregullore nr. 376, datë 17.11.1997, e Ministrisë së Shëndetësisë)

Ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011) rregullon procedurat për hartimin dhe miratimin e Planeve Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve:

- Miratimi i PVMIM nga Këshilli Bashkiak
- PVMIM hyjnë në fuqi vetëm pas miratimit nga Këshilli i Qarkut;
- Rishikimi i PVMIM të paktën çdo gjashtë vjet;
- Raportet vjetore mbi statusin e zbatimit në këshillin e qarkut në formatin e përcaktuar nga Ministri.
- Raportim vjetor në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i përcakton bashkitë si nivel bazë të njësisë së vetëqeverisjes lokale, i cili përbëhet nga disa njësi administrative. Për më tepër, ligji rregullon të drejtën dhe përgjegjësinë e bashkive, ndër të tjera për krijimin dhe grumbullimin e të ardhurave, vendosjen e tarifave vendore për shërbimet dhe përcaktimin e tarifave të tyre, bashkëpunimin me NJQV të tjera. Ligji gjithashtu përcakton përgjegjësinë e bashkive në mbledhjen, asgjësimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

Ligji “Për financat vendore” (Ligji nr. 68, datë 27.04.2017) paraqiti konceptin e mbulimit të shpenzimeve përmes tarifave. Bazuar në këtë ligj, niveli i tarifave është i orientuar drejt mbulimit të kostove të shërbimeve publike të ofruara nga NJQV. Qeverisja vendore mund të caktojë tarifa vetëm për shërbimet publike, konsumi ose përfitimi i të cilave, në parim, është i matshëm për përdoruesit ose përfituesit, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar akses, cilësi, sasi dhe kosto të përballueshme nga të gjithë.

Sipas Ligjit nr. 125, datë 25.04.2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar (Ligji nr.77, datë 16.07.2015), koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP) mund të jepen për kryerjen e punëve dhe ofrimin e shërbimeve, ndër të tjera, edhe për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe ruajtjen (Neni 4ç). Ky amendim tregon se bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik dhe sektorit privat është pjesë e politikës së qeverisë për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve.


Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, përkufizon infrastrukturën publike si tërësinë e rrjeteve, instalimeve dhe ndërtimeve ekzistuese ose të planifikuara në territor, si dhe hapësirat publike, duke synuar realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, energjisë, menaxhimit të ujit, komunikimeve elektronike, arsimit, shëndetësisë, menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, menaxhimin e burimeve natyrore dhe kulturore, mbrojtjen kombëtare, civile dhe të zjarrit dhe fusha të tjera të ngjashme duke i shërbyer publikut. Infrastruktura publike ka karakter kombëtar ose vendor dhe kryhet me investime publike ose private (Neni 3.11).

VKM Nr. 389, datë 27.6.2018 miraton ndryshime në VKM Nr. 452, datë 11.07.2012 "Për vend depozitimet" dhe përcakton ndër të tjera standardet për rehabilitimin dhe funksionimin e vend depozitimeve.

VKM nr. 319, datë 31.5.2018 ofron udhëzime për llogaritjen e kostove për menaxhimin e mbetjeve.

VKM nr. 418, datë 25.6.2014 përcakton objektivat e riciklimit për NJQV-të, të cilat duhet të marrin masat e duhura për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, të paktën për letrën / kartonin, metalin, plastikën dhe qelqin.

PVMIM është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare dhe bazuar në Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Qarkut Berat.






Figura 1 Krahasimi i objektivave dhe synimeve të shënjestruara për MMN

1.3 Rolet dhe përgjegjësia në nivelin kombëtar, rajonal dhe vendor

1.3.1 Niveli kombëtar

Përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri ndahen në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Ligji Nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” është legjislacioni kyç që përcakton përgjegjësitë institucionale në fushën e menaxhimit të mbetjeve për autoritetet qendrore, përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe agjencitë vartëse të saj, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM).

MTM luan rolin udhëheqës në kuadrin e përgjithshëm rregullator dhe politik për të gjitha llojet e mbetjeve dhe mbikëqyr tërësisht administrimin e mbetjeve të rrezikshme. Kjo ministri është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për menaxhimin e mbetjeve në vend. Së bashku me institucionet e tjera vartëse, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, ministria ka përgjegjësinë e plotë për krijimin dhe monitorimin e një sistemi të menaxhimit të mbetjeve.

MIE mbulon investimet për infrastrukturën dhe zhvillimin e standardeve dhe teknikave më të mira për menaxhimin e mbetjeve bashkiake dhe mbetjeve nga ndërtimi dhe prishja e objekteve, si dhe ciklin (planifikimin, hartimin dhe zbatimin) e projektit në lidhje me ndërtimin e vend depozitimeve rajonale dhe përcakton kriteret teknike. Ministria gjithashtu koordinon dhe monitoron aktivitetet në vendgrumbullimet e mbetjeve, vend depozitimet rajonale dhe impiante e incineratorë, si edhe garanton mbylljen e vendgrumbullimeve urbane. MIE ka patur përgjegjësinë për mbledhjen e të dhënave për mbetjet bashkiake dhe ato inerte dhe për shumë vite ka qenë burimi kryesor i informacionit në lidhje me sasinë e mbetjeve të gjeneruara në vend.

1.3.2 Niveli rajonal

Këshillat e qarkut përbëjnë nivelin e dytë të qeverisjes vendore në Shqipëri. Edhe pse jo drejtpërsëdrejti përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal, ato ligjërisht janë ngarkuar për të siguruar kuadrin e politikave rajonale nëpërmjet planeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve duke i harmonizuar me politikat kombëtare. Këshillat hartojnë dhe miratojnë planet rajonale për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe i raportojnë MTM çdo vit për zbatimin e tyre (neni 13, Ligji nr. 156/2013 amendim i Ligjit nr. 10463/2011). Gjithashtu këshillat janë përgjegjës për miratimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve para hyrjes në fuqi të tyre. Roli i këshillave të qarqeve është rishikuar vitet e fundit. Strategjia MIM sugjeron një rol të reduktuar për Këshillat e Qarkut në menaxhimin e mbetjeve, duke lejuar studime

fizibiliteti në nivel zone mbetjesh që zbatojnë planet vendore të menaxhimit të mbetjeve. Strategjia MIM rekomandon të rishikohen ligjet kyç për të amenduar rolin e Këshillit të Qarkut.

1.3.3 Niveli vendor

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e NjQV-ve në lidhje me menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, grumbullimi, transportimi, asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve të bashkive është përcaktuar si funksion i vetë bashkive. Sipas këtij përcaktimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë t’i menaxhojnë këto shërbime në mënyrën më të përshtatshme për kushtet specifike të bashkisë, të bashkëpunojnë me bashkitë e tjera, të caktojnë pagesat dhe tarifat e shërbimit si edhe një mekanizëm për mbledhjen e të ardhurave, të ndërtojnë dhe administrojnë objektet për trajtimin e mbetjeve.

Detyrat specifike të menaxhimit të mbetjeve për bashkitë përcaktohen në Ligjin Nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe disa akte nënligjore. Përgjegjësitë e e bashkive lidhen me planifikimin dhe raportimin për menaxhimin e mbetjeve në juridiksionin përkatës. Në nivel vendor, shërbimet për MMN ofrohen ose me personelin dhe pajisjet e vetë bashkive ose nëpërmjet kontraktorëve privatë. Ende i bëhet referencë Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, në lidhje me kontraktimin e palëve të treta për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve.

2 Konteksti vendor për menaxhimin e mbetjeve të ngurta

2.1 Profili i Bashkisë

Bashkia Poliçan shtrihet në pjesën qendrore jugore të Republikës së Shqipërisë dhe kufizohet me Bashkitë Berat, Skrapar dhe Memaliaj. Kjo bashki është pjesë përbërëse e qarkut të Beratit dhe karakterizohet nga një reliev i pasur me një mozaik luginash, kodrash dhe vargjesh malore, që shtrihen nga 200 m mbi nivelin e detit në luginën e Osumit deri në 2416 m në majën Çuka Partizane, në malin e Tomorrit (me 75% të territorit në lartësinë 600–1000 m). Pas reformës administrative territoriale, Bashkia e Poliçanit përbëhet nga 3 Njësi Administrative (NJA): Poliçan, Vërtop dhe Tërpan, ndërsa qendra e bashkisë është qyteti i Poliçanit.

Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Poliçan, bazuar në shtrirjen, përdorimet e tokës dhe aktivitetet që kryhen në to, territori ndahet në disa zona:

- Zona e Mjedisit Natyror, e cila përfshin zonat e mbrojtura natyrore, Parkun Kombëtar të Tomorrit dhe Parkun Natyror Balloll.
- Zona e Zhvillimit Rural, përfshin terrene kodrinore e malore, bujqësore e natyrore,
- Zona e Zhvillimit Bujqësor, zonat e kultivuara në mënyrë intensive duke mbështetur ekonominë lokale.
- Zona e Zhvilimit të Veçantë Bujqësor, ku përqendrohet kultivimi lokal i sherebelës.
- Zona Ekonomike, e cila grumbullon veprimtaritë industriale me ndikime të ulëta dhe të mesme në mjedis, por dhe aktivitete të tjera ekonomike, shërbime, afër me qendrën urbane të bashkisë
- Zona Ushtarake në hapësirën e instalimeve të industrisë ushtarake
- Zona e Zhvillimit Urban përfshin të gjitha zonat e banuara që janë të mbyllura nga vija e gjelbër.




Figura 2 Harta e territorit të Bashkisë Poliçan sipas zonave

Mjedisi natyror

Parku Kombëtar i Malit të Tomorrit është një perlë e natyrës së egër shqiptare me sipërfaqe 24,723 ha që shtrihet në lindje të rrugës nacionale Çorovodë – Poliçan – Berat. Ky ekosistem natyror u shpall park kombëtar me Vendim nr. 472 datë 18.07.2012. Zona ka një biodiversitet të pasur, me mbi 950 specie të ndryshme bimore, nga të cilat 6 janë bimë endemike dhe 11 subendemike, si dhe mbi 200 lloje bimësh me vlera ekonomike dhe mjekësore. Përveç peizazhit dhe vlerave natyrore, kjo zonë paraqet edhe vlera kulturore, historike e fetare të cilat e bëjnë një atraksion turistik për një larmi aktivitetesh.



Figura 3 Pamje nga Parku Kombëtar i Malit të Tomorrit

Zona e mjedisit natyror përfshin dhe Parkun Natyror Balloll, i cili shtrihet në një sipërfaqe 330 ha në një reliev kodrinor në perëndim të Tërpanit. Flora e tij karakterizohet nga pyje shekullorë, veçanërisht dushku dhe bimësi shkurrore, e njohur për frutat e pyllit dhe bimët farmaceutike dhe në faunë spikat derri i egër. Edhe kjo zonë ofron mundësi për të zhvilluar aktivitete rekreative në natyrë, kërkim shkencor dhe edukim mjedisor. Monumentet e mbrojtura natyrore përfshijnë Shpellën e Kapinovës, Rrapin e Lybeshës dhe Rrapin e Zhitomit.

Vendbanimet dhe demografia

Bashkia Poliçan ka kryesisht karakter rural. Ajo ka nën administrimin e saj 1 qytet dhe 26 fshatra që ndodhen të shpërndara në zona kodrinore dhe malore. Njësia e Poliçanit dhe Vërtopit shtrihen përgjatë luginës, ndërsa njësia e Tërpanit përbën skajin më të largët të Bashkisë dhe është tërësisht zonë malore. Vendndodhja përgjatë luginës përcakton edhe komunitetet lokale me standard më të mirë jetese, në krahasim me ato që ndodhen më larg luginës. NJA Tërpan përfshin numrin më të madh të fshatrave, 14 gjithsej, nga të cilët më të largët janë: Rehovë, Panarit, Çorogjaf, Lugas, Zhapokikë, Plashnik i Madh dhe Molisht. Ndërkohë që edhe disa fshatra të NJA Vërtop janë të shpërndara në zonat malore, si Tomorr i Madh, Tomorr i Vogël, Kapinovë dhe Lybeshë. Lidhja midis vendbanimeve dhe qendrës së bashkisë është e vështirë për arsye të largësisë dhe infrastrukturës së dobët rrugore.

Qyteti i Poliçanit u ndërtua në vitet 1960 si një bazë e industrisë mekanike dhe asaj ushtarake. Ai shtrihet në një terren kodrinor në lartësinë mesatare 519 m, por prania e luginës së Osumit në veriperëndim të Poliçanit krijon një klimë të tipit mesdhetar. Ujërat e lumit përdoren për furnizimin e qendrave të banuara, prodhimin e energjisë elektrike dhe për ujitjen e kulturave bujqësore. Në një

largësi prej 10 km nga qyteti i Poliçanit ngrihet mali i Tomorrit me potenciale të mëdha natyrore për turizmin alpin dhe eksplorimin e natyrës nga turistët, gjeografët e biologët.

Zyrtarisht ka dy burime kryesore të dhënash për popullsinë, Censusi i vitit 2011 dhe regjistri i Gjendjes Civile. Këto dy regjistra raportojnë të dhëna të ndryshme për popullsinë në Bashkinë Poliçan, përkatësisht (Census 2011) 10,953 banorë për të tre njësitë administrative dhe (Gjendja Civile 2021) 16,819 banorë. Ndërsa sipas të dhënave nga kryepleqtë e fshatrave, popullsia e bashkisë arrin në vetëm rreth 8,000 banorë. Diferenca midis të dhënave nga këto burime arrin deri në 50% të popullsisë. Ndërsa sipas gjinive, popullata ndahet në mënyrë të balancuar me 50% femra dhe 50% meshkuj. Për shkak të terrenit malor në pjesën më të madhe të territorit të bashkisë popullsia është e shpërndarë në një numër të madh fshatrash me dendësi relativisht të ulët.

Tabela 3 Popullsia (2021) sipas të dhënave të kryetarëve të fshatrave

Njësia administrative	Popullsia (nr. banorë, 2021)	Tipi i vendbanimit	Qytete dhe fshatrat
Poliçan	3,500	Qendra vendore	Poliçan
Vërtop	3,718	Zonë bujqësore kodrinoro-malore	Mbrakull, Vërtop, Kapinovë, Zgërbonjë, Vodicë, Fushë Peshtan, Drenovë, Lybeshë, Tomorr i Madh, Tomorr i Vogël, Bregas, Vodicë
Tërpan	950	Zonë bujqësore kodrinore	Tërpan, Teman, Paskuar, Tozhar, Vokopolë, Dodovec, Rehovë , Zhapokikë, Çorogjaf, Panarit, Plashnik i Madh, Lugas, Zhitom i Madh, Zhitom i Vogël
Gjithsej	8,168		

Ndërsa nëse i referohemi llogaritjes së popullsisë të përdorur edhe në Planin Kombëtar Sektorial dhe Planin Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve të Qarkut Berat, të cilat bazohen në formulën e përdorur nga Ministria e Financave për shpërndarjen e granteve tek NJQV: Census + (Gjendje Civile – Census) * 30%, popullsia e Bashkisë Poliçan llogaritet të jetë 12,306 banorë.

Vlen të theksohet fakti që e gjithë zona është prekur nga migrimi dhe popullsia vijon të pësojë rënie në mënyrë konstante që nga viti 1990.

Rrjeti rrugor

Infrastruktura rrugore në bashkinë e Poliçanit përbëhet nga rrjeti rrugor nacional dhe lokal. Rruga nacionale Berat-Poliçan-Skrapar është e rëndësishme për shkak të lidhjes që krijon me shumë site turistike. Infrastruktura rrugore është e dobët dhe nuk ka pasur shumë ndërhyrje apo investime, duke penguar zhvillimin e zonave rurale, sidomos në pjesën malore. Për shkak të mungesës së rrugëve ndërlidhëse ofrimi i shërbimeve në këto zona është shumë i

kushtueshëm. Veçanërisht pozicioni gjeografik i NJA Tërpan dhe distancat e largëta të fshatrave të kësaj njësie nga qendra e bashkisë paraqesin vështirësi në transport dhe në ofrimin e shërbimeve.

Zhvillimi ekonomik

Bashkia e Policanit paraqet një zonë ekonomike mikse. Sektorët si bujqësia, blegtoria, agro-industria, turizmi, tregtia dhe shërbimet përbëjnë drejtimet ekonomike, në të cilat popullata lokale është e përfshirë. Forca shtytëse kryesore ekonomike është sektori i bujqësisë, i ndjekur nga sektori i shërbimeve. Gjatë viteve të fundit, numri i ndërmarrjeve bujqësore është rritur ndjeshëm, çka mund të shpjegohet me shtrirjen e kufirit bashkiak sipas TAR 2015 në zonat rurale. Bujqësia karakterizohet nga ferma shumë të vogla bujqësore familjare, të cilat nuk arrijnë rendimente të larta. Ndërsa, vreshtat janë kthyer në aktivitet tradicional, veçanërisht në Vërtop. Ashtu si bujqësia, edhe blegtoria përbën një nga drejtimet kryesore ekonomike të popullatës në pjesën rurale të bashkisë. Pjesa rurale e luginës është më e favorshme për mbarështimin e gjedhit, ndërsa pjesa kodrinore-malore për mbarështimin e bagëtive të imëta, favorizuar nga mjedisi natyror dhe niveli i lartë i kullotave. Produktet blegtorale kryesore janë qumështi, nënproduktet e tij dhe mishi, për të cilat kjo zonë është e mirënjohur.

Numri i bizneseve është i kufizuar dhe shumica e tyre ushtrojnë aktivitet në qytetin e Poliçanit. Në të gjithë territorin e bashkisë operojnë 160 biznese të vogla, 26 të mëdha, 13 institucione dhe 30 tregtarë në tregun e lirë në qytet. Më shumë se 90% e bizneseve janë të vogla, me vetëm një deri në katër punonjës.

Kategoria e popullsisë së aftë për punë përbën 40% të gjithë popullsisë, por vetëm një përqindje e vogël është aktualisht e punësuar si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Faktori emigracion ka luajtur ndikim të madh në largimin e të rinjve të aftë për punë. Lëvizjet demografike jashtë vendit apo edhe drejt qyteteve të tjera janë pasojë e kushteve të vështira të jetesës dhe mungesës së punësimit në këtë zonë. Të rinjtë që largohen për të ndjekur studimet e larta pas moshës 18 vjeçare, nuk kthehen më pas diplomimit.

Numri total i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike është 214 familje (Mars 2021), ndërsa numri i personave me aftësi ndryshe sipas kategorive është 507. Tabelat më poshtë tregojnë më të detajuar numrin e përfituesve të ndihmës ekonomike sipas njësive dhe numrin e personave me aftësi ndryshe për secilën kategori.

Tabela 4 Familjet që trajtohen me Ndihmë Ekonomike sipas Njësive Administrative

Njësitë Administrative	Nr. i përfituesve me Ndihmë Ekonomike		
	2019	2020	2021
Nj.A.Poliçan	85	88	58
Nj.A.Vërtop	109	117	111
Nj.A.Tërpan	56	50	45

Tabela 5 Personat me aftësi ndryshe sipas kategorive në Bashkinë Poliçan

Kategoritë e Personave me Aftësi ndryshe	Nr. i personave për secilën kategori		
	2019	2020	2021
PAK	155	234	205
Verbëri	81	76	71
Para/Tetraplegjik	21	21	19
Invalidë Pune	226	218	202

2.2 Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në bashki

Drejtoria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për shërbimin publik të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Struktura e kësaj drejtorie është e përbërë nga këto pozicione: Drejtori, Specialisti i Shërbimeve Publike, Supervizori, Specialisti i Mjedisit dhe punonjësit e shërbimeve.




Figura 4 Struktura organizative e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Aktualisht në bashki nuk ka një strukturë specifike për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Shërbimin e pastrimit bashkia e ofron me kontraktues privat “Cotoni Center” shpk. Kontrolli i zërave të punimeve që realizon firma ndiqen nga Supervizori, i cili është në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Specialisti i Mjedisit trajton çështjet mjedisore në nivel vendor në kuadër të zbatimit të strategjisë kombëtare të mjedisit. Në strukturën e Drejtorisë bëjnë pjesë dhe 10 punonjës shërbimi të cilët punojnë për kryerjen e të gjitha shërbimeve publike në Poliçan

dhe Vërtop dhe ndër të tjera pastrojnë në zonat që nuk janë parashikuar në kontratën e shërbimit për arsye të infrastrukturës rrugore dhe terrenit të vështirë.

2.3 Sasitë e mbetjeve, burimet dhe karakteristikat

Në bashkinë Poliçan nuk ka një sistem monitorimi për sasitë e grumbulluara të mbetjeve, pasi kamioni që transporton mbetjet në vend depozitim nuk peshohet. Sasitë e mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara përllogariten vetëm mbi bazën e disa parametrave, si norma specifike e gjenerimit të mbetjeve, numri dhe distancat e rrugëve që përshkojnë mjetet e grumbullimit, etj. Aktualisht përdoren normat:

0.7 kg/banor/ditë në zonën urbane

0.5 kg/banor/ditë për zonën rurale

0.3 kg/banor/ditë për zonën sub rurale

Mbledhja aktuale e mbetjeve bashkiake përfshin mbetjet e gjeneruara nga familjet, bizneset dhe institucionet. Mbetjet e grumbulluara nga subjektet përmes skemës bashkiake përfshijnë vetëm mbetjet e ngjashme me mbetjet shtëpiake. Sasia mesatare e mbetjeve urbane të grumbulluara është 3.2 tonë/ditë dhe sasia vjetore 1168 tonë/ vit. Bashkia me urdhër të Kryetarit ngriti grupin e punës për grumbullimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre. Nga verifikimet e bëra në terren për numrin e popullsisë rezidente që ndodhet në territorin ku ofrohet shërbimi, u llogarit kjo sasi mbetjesh, e cila u përdor edhe për lidhjen e kontratës së shërbimit me firmën kontraktore në vitin 2021 nëpërmjet procedurës së tenderimit.

Ndërkohë në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (Plani Sektorial) përfshihet një përllogaritje e sasive të mbetjeve që prodhohen dhe grumbullohen në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, përfshirë bashkinë Poliçan. Përllogaritja e kryer në vitin 2018, bazuar në të dhënat e marra nga bashkia nëpërmjet një pyetësori, gjatë fazës së parë të projektit për menaxhimin e mbetjeve në Qarkun Berat, paraqitet si më poshtë:

Tabela 6 Të dhënat për sasitë e mbetjeve sipas Planit Sektorial MIM

Sasitë e mbetjeve të prodhuara [t/vit]	2,062
Sasitë e mbetjeve të grumbulluara [t/vit]	1,482
Norma e grumbullimit	72%

Përbërja e mbetjeve

Sipas të dhënave nga një studim i kryer në kuadër të projektit INPAEL të mbështetur nga BE në 2009, përbërja e mbetjeve në gjithë Qarkun e Beratit paraqitet si më poshtë:




Figura 5 Përbërja e mbetjeve në Qarkun e Beratit

Sipas analizës së kryer me mbetjet e grumbulluara, rezulton që pjesa e fraksionit organik është më e ulët në njësitë administrative rurale se sa në qytetin e Poliçanit. Mund të supozohet se një sasi e caktuar e mbetjeve organike të prodhuara nga familjet në zonat rurale përdoren në mjediset e tyre për kompostim ose ushqimin e kafshëve. Kjo bën që sasia e mbetjeve organike në pikat e grumbullimit të jetë më e ulët.




Figura 6 Përbërja e mbetjeve në qytet dhe zonat rurale të Bashkisë Poliçan

Siç tregohet në grafikët e mësipërm, pjesën më të madhe e zënë mbetjet organike. Fraksionet e mbetjeve të riciklueshme zënë gjithsej 28% të sasisë së mbetjeve në qytet dhe 40% në zonat rurale.

Në Bregas, prodhohet sasia më e madhe e mbetjeve organike, ndaj në këtë fshat është caktuar një vend për depozitimin e mbetjeve të gjelbra. Megjithatë në vendin e caktuar nuk kryhet ndonjë proces pune për të ndihmuar procesin natyror të dekompozimit të këtyre mbetjeve. Veç kësaj vihet re që mbetjet organike në fund të sezonit të prodhimit bujqësor kanë përmbajtje të

mbetjeve të tjera me përbërje plastike (fijet që përdoren për lidhjen e bimëve). Edhe kur këto mbetje organike hidhen në tokë për t'u përzjerë me dheun dhe për t'u kompostuar, gjatë punimit të tokës nxirren në sipërfaqe fijet plastike që nuk janë të biodegradueshme.

Një sasi e konsiderueshme mbetjesh organike prodhohet edhe nga trajtimi dhe krasitja e pemëve të ullirit. Për shkak të terrenit të thyer dhe mungesës së rrugëve është e vështirë mbledhja apo transportimi i degëve të prera në një vend të përbashkët. Zakonisht kjo masë grumbullohet dhe lihet brenda territorit të ullishtës, por jo rrallëherë ka dhe zjarrvënie të qëllimshme të tyre me pasoja për gjithë zonën e pyllëzuar përreth.

2.4 Shërbimet aktuale të menaxhimit të mbetjeve

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkinë Poliçan ofrohet me operator privat: firmën "Cotoni Center" sipas kontratës së shërbimit të lidhur në 24 maj 2021, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare 2021–2026, me të drejtë rishikimi çdo vit të kontratës. Infrastruktura e dobët e rrugëve bën që shërbimi të ofrohet vetëm në qytet dhe në zonat rurale përgjatë rrugës nacionale. Shërbimet përfshijnë pastrimin e rrugëve, mbledhjen e mbetjeve dhe depozitimin e tyre.


2.4.1 Pastrimi i rrugëve

Bashkia Poliçan ka përcaktuar rrugët, sheshet e trotuarët dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar. Punonjësit e Kontraktuesit fshijnë me fshesë dore dhe kryejnë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse të parashikuara në metodologji. Fshirja e ambienteve publike kryhet manualisht në një sipërfaqe totale prej 33,000 m^2, 1 herë në ditë.

Në fshatrat e njësisë Vërtop ku kryhet shërbimi i pastrimit të rrugëve, nuk bëhet fshirja e sipërfaqeve të rrugëve, por një punëtor kryen largimin e mbetjeve (letra, qese, etj.) që hidhen çdo ditë pa kriter.

2.4.2 Grumbullimi i mbetjeve dhe transporti

Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve ofrohet në qytetin e Poliçanit dhe lagjet përreth tij dhe në disa fshatra të njësisë administrative Vërtop, të cilët shtrihen përgjatë rrugës nacionale Poliçan – Berat. Sot, rreth 8,000 banorë në Bashkinë Poliçan përfitojnë nga shërbimi i pastrimit dhe largimit të mbetjeve. Duke pasur parasysh numrin e popullsisë prej 11,569 banorësh të përllogaritur në Planin Rajonal MIM për këtë vit, mbulimi me shërbim i popullsisë llogaritet në masën 69%.



Fshatrat që mbulohen me shërbim në njësinë administrative Vërtop janë: Mbrakull, Vërtop, Fushë Peshtan, Bregas dhe Vodicë.

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportimit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në proceset e punës si më poshtë:

Zbrazje e kontenierëve

Kryhet me makinë teknologjike të përcaktuar për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve të hedhura. Kamioni vetëngjeshës me kapacitet 5 tonë kapacitetin aktual të ngarkimit për një përbërje tipike mbetjesh e ka rreth 85% të kapacitetit total mbajtës.

Pastrim i pikës së grumbullimit

Përreth çdo pike grumbullimi kryhet pastrimi dhe fshirja me fshesë e sipërfaqes prej 10 m^2.

Rivendosje e kontenierëve

Kontenierët e zbrazur sistemohen në pozicion vertikal në vendin e caktuar.

Dezifektim me klor

Dezinfektimi me klor bëhet brenda çdo kontenieri dhe përreth tij, pas çdo zbrazje të tij. Në periudhën e verës dezinfektimi i pikave të grumbullimit bëhet çdo ditë. Operatori i shërbimit duhet të lajë dhe dizifektojë 120 kontenierë të volumeve 1.1m³ brenda muajit.

Transportim

Transporti i mbetjeve me kamion teknologjik për në sheshin e vend depozitimit të mbetjeve. Kamioni kryen vetëm një turn gjatë ditës.

Grumbullimi aktualisht kryhet me anë të 120 kontenierëve prej metali me volum 1.1 m^3 në 53 pika grumbullimi, nga të cilat 21 ndodhen në qytet dhe 32 nëpër fshatra. Largimi i mbetjeve nga kontenierët realizohet çdo ditë dhe me interval një herë në ditë në territorin ku ofrohet shërbimi.

Mbetjet grumbullohen të përziera. Edhe pse jane tentuar iniciativa per riciklimin e mbetjeve, për shkak të nivelit të ulët të ndërgjegjësimit, por edhe mungesës së infrastrukturës për riciklimin e trajtimin e tyre, këto iniciativa nuk kanë funksionuar.

2.4.3 Depozitimi i mbetjeve

Bashkia Poliçan aktualisht ka dy vend depozitime të miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak, një për mbetjet urbane dhe një vend depozitim për mbetjet inerte. Vend depozitimi i mbetjeve urbane ndodhet në zonën F, në pasurinë nr.19, ZK 3019.



Figura 7 Planvendosje e vend depozitimit të mbetjeve urbane

Në vend depozitimin e mbetjeve urbane nuk kryhet ndonjë proces për ndarjen apo trajtimin e mbetjeve. Ato shkarkohen dhe shtyhen të përzjera në këtë vend depozitim ku terreni nuk lejon zbatimin e proceseve të tjera si ngjeshja dhe mbulimi. Siç tregohet dhe në figurën e mëposhtme, vend depozitimi nuk i përmbush standardet e nevojshme ligjore dhe mjedisore dhe ka raste të djegies së mbetjeve.



Figura 8 Vend depozitimi aktual i mbetjeve urbane

Mbetjet inerte të krijuara nga ndërtimi dhe prishja e objekteve në Bashkinë Poliçan depozitohen në vend depozitimin Nr. 02 (nga identifikimi i vend depozitimeve), i cili ndodhet në afërsi të vend depozitimit të mbetjeve urbane dhe afërsisht 7 km larg qendrës së Poliçanit dhe ka një sipërfaqe prej 1 ha. Ky vend depozitim i mbetjeve inerte është i miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendim nr. 02 dt. 28.02.2014.




Figura 9 Planvendosja e vend depozitimit të mbetjeve inerte

Aktualisht është konstatuar që bizneset që ushtrojnë aktivitetin e përpunimit të pllakave të gurit në Vodicë i depozitojnë mbetjet në një vend informal në afërsi të lumit.




Figura 10 Vend depozitime të identifikuara nga studimi i MTM (Raporti final, 2018)

Në Raportin Final (2018) të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për studimin "Zbutja e riskut ne vend depozitime" të ndërmarrë me mbështetjen e DLDP, Bashkia Poliçan referon 8 vend depozitime nga të cilat 2 të aprovuara nga Këshillat Lokale dhe të tjerat ilegale. Vlen të theksohet se të gjitha vend depozitimet ilegale në territorin e kësaj bashkie janë vend depozitime mbetjesh inerte (hedhje mbetjesh nga subjektet e përpunimit të pllakave të gurit). Për to bashkia propozon largimin e mbetjeve dhe rehabilitimin e terrenit. Për dy vend depozitimet në Lagjen Plirëz, njëra për mbetjet urbane dhe tjetra për inertet, përkatësisht 2,600 m^2 dhe 2,000 m^2, grupi i punës rekomandon rehabilitimin e tyre".

2.5 Ekonomia dhe financimi i menaxhimit aktual të mbetjeve

Kostoja vjetore e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve 2021 në Bashkinë Poliçan llogaritet në vlerën 13,345,189 lekë dhe përfshin zërat e shërbimit si më poshtë:

Nr.	Zërat	Vlera
1	Fshirje rruge, sheshe, trotuare në qytetin e Poliçanit	4,970,972
2	Largim dhe transport i mbetjeve me mjet teknologjik	6,150,019
	TVSH	2,224,198
	Total	13,345,189

Tarifa vjetore e pastrimit për familjet ishte 300 lekë, ndërsa për bizneset e vogla në varësi të aktivitetit të tyre varionte nga 6,000 – 35,000 lekë dhe për bizneset e mëdha dhe institucionet 30,000 – 500,000 lekë. Për të stimuluar biznesin e ri në juridiksionin e Bashkisë Poliçan si dhe për t'i inkurajuar të rinjtë të marrin nisma tregtare, për vitin 2021 ishte parashikuar që çdo i ri i moshes 18-30 vjeç, drejtues i një biznesi / përfaqësues ligjor i tij do të përfitonte 30% ulje të tarifave dhe taksave vendore.

Bazuar në të ardhurat e pritshme të realizuara në vitin 2021 dhe koston e shërbimit, rezulton një mbulim nga të ardhurat në masën 70%, ku vihet re një mbulim shumë i vogël nga familjet, vetëm 2%.

Sipas ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, neni 18/2, niveli i tarifave të shërbimeve publike, si rregull, synon mbulimin e kostos dhe është në përpjesëtim të drejtë me konsumin nga individët, personat fizikë ose juridikë. Pra, kosto operative e shërbimit duhet të mbulohet nga familjet dhe bizneset që përfitojnë shërbimin. Tarifat e pastrimit për familjet dhe bizneset për vitin 2022 paraqiten të përmbledhura si më poshtë:

Nr.	Kategoritë	Niveli i tarifës
1.	**FAMILJET**	**Lekë/familje/vit**
1.1	*Njësia Administrative Poliçan*	*450*
1.2	Njësitë e tjera administrative	
	NJA Vërtop (5 fshatrat)	*300*
	NJA Tërpan	*0*
2.	**BIZNESE**	**Lekë/vit**
2.1	Biznes i vogël	
	NJA Poliçan	*7,200 – 42,000*
	Njësitë e tjera administrative	
	NJA Vërtop	*5,500 – 16,500*
2.2	*Biznes i madh*	
	NJA Poliçan	36,000 – 120,000
	Njësitë e tjera administrative	

	NJA Vërtop	33,000 – 550,000
3	**INSTITUCIONE**	**Lekë/vit**
	Të gjitha njësitë administrative	25,000 – 60,000

Këtë vit për herë të parë është aplikuar tarifa e pastrimit për familjet në pesë fshatrat e NJA Vërtop në të cilat ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve. Mbledhja e tarifave për familjet kryhet nga Bashkia, nëpërmjet derdhjes së detyrimit direkt në arkat e bashkisë. Në analizën e kryer për vitin 2022 deri në muajin Tetor, mbulimi i kostos ishte në nivelin 48%. Pjesa tjetër mbulohet nga buxheti i bashkisë.

Krahasuar me familjet rezidente që faturohen nga Zyra e Taksave të Bashkisë (njoftohen për detyrimin), kanë paguar vetëm 52% e familjeve në vitin 2021 dhe vetëm 23% e familjeve deri në Tetor 2022. Kjo është pjesërisht për shkak të kushteve të vështira për mbledhjen e mbetjeve (në zonat malore me popullsi të rrallë), por edhe për shkak të shpenzimeve të larta. Ndërsa përqindja e bizneseve dhe institucioneve që paguajnë tarifën e pastrimit në zonën e shërbimit kundrejt atyre të tarifuara ka qenë 83% (deri në Tetor 2022).

Në vitin 2022, bashkia u ka tarifuar bizneseve, qytetarëve dhe institucioneve 62% të kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve (kontrata e shërbimit 19,787,000 lekë/vit). Nga shuma e faturuar në 2022, është mbledhur 78% e tarifave në zonën e shërbimit (deri në Tetor 2022).

Buxheti i alokuar për shërbimet MIM kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuara nga bashkia ka qenë 11,425 Lekë shpenzime për 1 tonë mbetje të menaxhuara në 2021, ndërsa në vitin 2022 është rritur në 16,940 Lekë/ ton mbetje.

2.6 Analizimi i tregut të riciklimit

Nuk ka një skemë të rregullt për grumbullimin e diferencuar dhe ndarjen e materialeve të ricikluesshme që në burim. Disa nisma të ndërmarra më parë për ndarjen e mbetjeve nuk kanë rezultuar të suksesshme për shkak të nivelit të ulët të ndërgjegjësimit dhe infrastrukturës së dobët. Ashtu si në të gjitha qytetet e vendit, ka grumbullues informalë që mbledhin materiale të ricikluesshme dhe mbetje voluminoze nga vetë banorët, ashtu si dhe pranë kontenierëve publikë apo në vendgrumbullimet e mbetjeve. Alumini dhe hekuri janë materialet më të parapëlqyera për shkak të vlerës së tyre, por ka një kërkesë në treg edhe për plastikën e përdorur.

Në qytetin e Poliçanit nuk ka ndonjë kompani të liçencuar për grumbullimin e materialeve të ricikluesshme dhe trajtimin e tyre. Subjekti më i afërt që ushtron aktivitet riciklues është kompania B-RECYCLE, në NJA Otllak, Bashkia Berat, e cila kryen ndarjen sipas llojit të materialeve plastike të ricikluesshme dhe më pas proceset e pastrimit, coptimit, ngjeshjes dhe paketimit të tyre gati për shitje.

2.7 Vlerësimi i gjendjes aktuale të menaxhimit të mbetjeve

Me rritjen e konsumit vitet e fundit vihet re një rritje e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe shumë banorë janë ende të pandjeshëm, apo të shkujdesur për pasojat e ardhshme financiare dhe mjedisore të sjelljeve tona. Megjithatë, pavarësisht këtyre sfidave, qyteti i Poliçanit në dekadën e fundit ka shënuar përmirësime inkurajuese, duke përfshirë një rritje të kujdesit për mjedise të pastra dhe një tendencë në rritje të qytetarëve që marrin përgjegjësi personale për mbetjet e ngurta që ata gjenerojnë.

Pjesa më e madhe e popullatës së Bashkisë Poliçan jeton në zonat rurale ku qarkullimi i mjeteve është i vështirë dhe grumbullimi i mbetjeve është shumë sfidues. Zbatimi i shërbimeve moderne për menaxhimin e mbetjeve në këtë territor është i pamundur, për shkak të mungesës së një sistemi rrugor të përshtatshëm për mjetet teknologjike, kohës së gjatë që nevojitet për të ofruar shërbimin në një territor kaq të thyer dhe për rrjedhojë financat e pamjaftueshme për të përballuar një shtrirje maksimale.

Menaxhimi i mbetjeve urbane, i cili aktualisht konsiston vetëm në grumbullimin e mbetjeve, depozitimin e tyre në vend depozitim dhe fshirjen e rrugëve, nuk përfshin të gjithë bashkinë Poliçan. Mungesa e infrastrukturës rrugore, infrastrukturës së grumbullimit e largimit të mbetjeve, por edhe edukata e ulët qytetare janë problematika që e vështirësojnë menaxhimin e mbetjeve.

Kostoja specifike e MMN e llogaritur është më e lartë se në bashkitë e tjera në qark, e cila lidhet me sasinë e vogël të mbetjeve të grumbulluara, terrenin e vështirë për grumbullimin e mbetjeve dhe popullatën e rrallë në të gjithë zonën e bashkisë. Pjesa më e madhe e kostove mbulohet nga tarifat e bizneseve, por nga ana tjetër të ardhurat e realizuara nga tarifat e familjeve mbulojnë një pjesë shumë të vogël (vetëm 2%) dhe në total 48% e kostos mbulohet nga tarifat, ndërsa pjesa tjetër subvencionohet nga buxheti i bashkisë. Financimi aktual i MMN nuk reflekton ende parimin “ndotësi paguan”.

Mbajtja e një sistemi modern për menaxhimin e mbetjeve në kushte kaq të vështira të zhvillimit ekonomik dhe të të ardhurave është një sfidë e vërtetë. Niveli i përballueshmërisë është shumë i ulët dhe duhet të zbatohet një përzierje e modeleve të menaxhimit për të arritur grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve. Për të mbështetur kërkesat e sistemit të ri, është e nevojshme një llogaritje më e mirë e kostos dhe rritje e shumës së fondit të akorduar për arritjen e objektivave të menaxhimit të mbetjeve. Duke marrë parasysh fondet aktuale të transferuara në Bashki dhe nivelin e infrastrukturës dhe të ardhurat, një rritje e tillë nuk mund të jetë e lehtë për t’u arritur.

3 Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve

3.1 Fushëveprimi i Planit Vendor

PVMIM për Bashkinë e Poliçanit do të mbulojë të gjitha njësitë administrative brenda kufirit të bashkisë. Plani është përgatitur për periudhën e zbatimit 2022–2027 dhe do të rishikohet dhe përditësohet në fund të kësaj periudhe.

Në bazë të legjislacionit ekzistues, plani do të përqëndrohet kryesisht në mbetjet urbane, për të cilat Bashkia Poliçan është drejtpërdrejt ose pjesërisht përgjegjëse. Sipas Katalogut të Mbetjeve, të miratuar me VKM nr. 402 datë 30.06.2021, emërtohen si mbetje urbane (kategoria 20) mbetjet shtëpiake dhe tregtare, mbetjet industriale dhe institucionale të ngjashme, përfshirë fraksionet e mbledhura veçmas. Strategjia Kombëtare MIM 2020–2035 përcakton mbetjet bashkiake, për menaxhimin e të cilave janë përgjegjëse Bashkitë, ku përfshihen:

- Mbetjet shtëpiake dhe të ngjashme
- Mbetjet e vëllimshme
- Mbetjet e kopshteve, gjethet, degët nga krasitjet, mbetjet nga pastrimi i rrugëve dhe tregjeve publike (mbetjet bio, sipas përkufizimit të Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011)
- Mbetjet nga aktivitetet tregtare, bizneset e vogla, zyrat dhe institucionet
- Mbetjet nga shërbimet e tjera bashkiake si parqet, lulishtet, etj. (mbetjet bio)

Aktivitetet e planit vendor të MMN përfshijnë fshirjen e rrugëve, grumbullimin e mbetjeve, grumbullimin e diferencuar dhe përpunimin e mbetjeve organike dhe të ricikluesshme, depozitimin e sigurt të mbetjeve urbane dhe atyre inerte, si dhe rehabilitimin e vend depozitimeve të mbetjeve urbane.

3.2 Të dhënat ku bazohet planifikimi

3.2.1 Parashikimi i popullsisë

Për të planifikuar shërbimet e menaxhimit të mbetjeve për 5 vitet e ardhshme, të dhënat kryesore që duhen marrë në konsideratë janë numri i banorëve dhe prirja demografike ndër vite. Numri i popullsisë në bashkinë Poliçan, ashtu sikundër në gjithë Qarkun e Beratit, ka pësuar rënie gjatë viteve të fundit dhe supozohet që kjo prirje të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.

Në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032 është zhvilluar një metodologji për parashikimin e numrit të popullsisë dhe sasisë së mbetjeve. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm paraqiten rezultatet e parashikimit të popullsisë për bashkinë e Poliçanit për periudhën 2022 deri në vitin 2042.

Tabela 7 Parashikimi i popullsisë në Bashkinë Poliçan për periudhën 2022–2042

Viti	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032
Popullsia e parashikuar	11569	11394	11221	11053	10887	10725	10565	10409	10256	10105	9957

Viti	2033	2034	2035	2036	2037	2038	2039	2040	2041	2042
Popullsia e parashikuar	9812	9670	9531	9394	9259	9128	8998	8871	8746	8624




Figura 11 Parashikimi i popullsisë të Bashkisë Poliçan

3.2.2 Parashikimi i sasisë së mbetjeve

Me qëllim parashikimin e administrimit të mbetjeve në të ardhmen në Bashkinë Poliçan është e rëndësishme të llogarisim prodhimin aktual të mbetjeve si dhe të parashikojmë zhvillimin për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Duke qenë se sot sasitë e mbetjeve nuk monitorohen, për qëllim planifikimi do të bazohemi në të dhënat e parashikuara në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032, në përputhje me bazën e re ligjore të përllogaritjes së popullsisë që do t'u shërbehet. Parashikimi i gjenerimit dhe grumbullimit të mbetjeve bazohet në shifrat e parashikimit të popullsisë. Në llogaritje, merren për bazë sasitë

specifike të gjenerimit të mbetjeve për lloje të ndryshme vendbanimesh sipas tabelës më poshtë[1].

Tabela 8 Sasitë specifike të gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit

Njësia Administrative	Llojet e vendbanimeve[2]	Lloji N°	Gjenerimi i mbetjeve [kg/pers/d]
Urbane			
Rurale			
Poliçan	Njësi vendore jo urbane me aktivitete miniera ose energji	32	0.55
Tërpan, Vërtop	Ekonomi bujqësore në zonat malore	44	0.4

Është supozuar që sasitë specifike të mbetjeve në secilin tip strukture të vendbanimit do të mbeten të pandryshuara. Sasitë e mbetjeve që do të gjenerohen në vitet e ardhshme (deri në vitin 2042) parashikohen si më poshtë:

Tabela 9 Parashikimi i sasisë së mbetjeve që do të gjenerohen në Bashkinë Poliçan

Viti	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032
Parashikimi i sasisë së mbetjeve (t/vit)	1,939	1,909	1,881	1,852	1,825	1,797	1,771	1,744	1,719	1,693	1,669

Viti	2033	2034	2035	2036	2037	2038	2039	2040	2041	2042
Parashikimi i sasisë së mbetjeve (t/vit)	1,644	1,621	1,597	1,574	1,552	1,530	1,508	1,487	1,466	1,445

Si rezultat i rënies së pritshme të numrit të popullsisë për shkak të migrimit, do të zvogëlohen edhe sasitë e mbetjeve që do të prodhohen gjatë këtyre viteve. Pritet që në fund të kohështrirjes së planit, në 2027, të prodhohen rreth 7% më pak mbetje. Për këtë arsye do të ulet edhe sasia e mbetjeve të grumbulluara. Por njëkohësisht, si rezultat i përmirësimit dhe shtrirjes së mbulimit me shërbim MMN në vitet e ardhshëm, pritet të rritet sasia e mbetjeve që do të grumbullohen në zonat malore. Referuar sasisë së parashikuar për vitin 2022 në Planin Kombëtar Sektorial për MMN dhe duke supozuar që norma e grumbullimit prej 72% (e vlerësuar në vitin 2018) nuk ka ndryshuar, mund të përllogaritet që sasia e mbetjeve që gjenerohen është 5.3 tonë në ditë dhe sasia që grumbullohet 3.8 tonë.

[1] Përkufizimi i llojeve të vendbanimeve për secilën njësi administrative është në përputhje me publikimin: Shqipëria – Tipologjia e komunave dhe bashkive (INSTAT, 2014).

[2] Llojet e vendbanimeve bazohen në Tipologjia e Komunave dhe Bashkive, të publikuar nga INSTAT. Shihni INSTAT: Tipologjia e Komunave dhe Bashkive Shqiptare; Maj 2014.

3.3 Kuadri strategjik

Zbatimi i këtij plani do të ketë si qëllim ofrimin e shërbimeve të zgjeruara për menaxhimin e mbetjeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik për një Bashki të pastër dhe tërheqëse dhe për një jetesë të shëndetshme. Kuadri strategjik i këtij Plani është ndërtuar mbi katër fusha kryesore: infrastruktura dhe shërbimet, zhvillimi institucional, qendrueshmëria financiare e shërbimeve dhe informimi e përfshirja e komunitetit, bazuar në modelin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve. Ky dokument i hartuar nga Grupi i Punës shpreh aspiratat dhe synimet e Bashkisë Poliçan për të ofruar shërbime efiçente dhe cilësore ndaj komunitetit të saj sipas

VIZIONIT

Një sistem gjithëpërfshirës i menaxhimit të mbetjeve të ngurta, i arritshëm nga çdo pjesëtar i komunitetit dhe i siguruar përmes partneritetit të plotë midis të gjitha niveleve të qeverisjes, bizneseve dhe shoqërisë civile, ku qytetarët e Bashkisë Poliçan kanë ndjenjë të pronësisë dhe përgjegjësisë për mbetjet që ata krijojnë, në mbrojtje dhe zhvillim të zonës me potenciale të mëdha turistike.

Për të përmbushur të gjitha dimensionet e këtij vizioni do të duhet të punohet njëkohësisht në disa drejtime, të cilat janë të ndërthurrura dhe plotësojnë kuadrin, në përputhje me kërkesat ligjore, parimet e menaxhimit të mbetjeve, nevojat dhe mundësitë e komunitetit të Bashkisë Poliçan.

Objektiva strategjikë:

1 Përmirësimi i shërbimeve MIM në Bashkinë Poliçan nëpërmjet teknologjive bashkëkohore, duke nxitur ndarjen në burim

2 Krijimi i strukturës funksionale dhe efiçente në bashki për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e performancës së shërbimit, që zhvillon kapacitetet me anë të trajnimeve

3 Performancë financiare e qendrueshme për ofrimin e shërbimit MIM me standard duke synuar mbulimin e kostos me tarifat

4 Komuniteti i ndërgjegjësuar me ndjenjën e pronësisë dhe përgjegjësisë për mbetjet që krijon, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të të gjitha grupeve komunitare

5 Parandalimi dhe reduktimi i mbetjeve në burim

Në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Poliçan (2017), në këtë plan të menaxhimit të mbetjeve merren parasysh propozimet për të zbatuar një sistem të integruar të menaxhimit të mbetjeve të ngurta me një organizim racional të infrastrukturës bazuar në kostot, ndikimet mjedisore, rrjetin e transportit, etj., konkretisht:

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit, duke rritur numrin e kazanëve të grumbullimit, aplikimin e teknologjive të pastra, praktikave të reduktimit të mbetjeve
- Forcimi i zbatimit të programeve të riciklimit dhe teknikave të tjera alternative të menaxhimit të mbetjeve
- Rehabilitimi i hapësirave ekzistuese të depozitimeve të mbetjeve me projekte rehabilitimi, konfigurimit fitoteknik, rikthimin e mjedisit në formën e vet origjinale
- Ndërtimi i një landfilli për groposjen higjienike të mbetjeve, për të shmangur rrjedhjen e lëndëve toksike, organike në tokën përreth dhe në akuifer
- Krijimi i një zone për depozitimin e materialeve inerte me qëllim reduktimin e inerteve që përfundojnë në përrenj dhe pika të pamiratuara

Direktiva Kuadër e BE-së për Mbetjet, e cila qëndron edhe në thelb të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, përcakton hapat për trajtimin e mbetjeve në bazë të prioriteteve. Këto hapa formojnë bazën e hierarkisë së mbetjeve, e treguar edhe në figurën e mëposhtme, e cila ilustron radhën e prioriteteve që duhet të merren parasysh në momentin e marrjes së vendimeve, përsa i përket përdorimit të burimeve dhe gjenerimit të mbetjeve në territorin e bashkisë.



3.3.1 Shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve

Objektivi strategjik 1:

Përmirësimi i shërbimeve MIM në Bashkinë Poliçan nëpërmjet teknologjive bashkëkohore, duke nxitur ndarjen në burim.

Ky objektiv përqendrohet tek sigurimi i infrastrukturës, ofrimi i shërbimeve dhe kujdesi për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zgjidhjeve teknike bashkëkohore, reduktimit të ndotjes dhe kthimit të burimeve natyrore në shërbim të komunitetit. Përcaktimi i tij merr parasysh Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Qarkut Berat (2019–2033) dhe Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Poliçan (2017).

3.3.1.1 Objektivi specifik 1.1: Shtrirja e shërbimit të MIM në territorin e bashkisë

Shtrirja e shërbimit do të bëhet me faza në varësi të kushteve të përshtatshme për qarkullimin e mjeteve/ infrastrukturës nëpër fshatra:

- 2022 – 2024: zgjerimi i zonës së shërbimit në tre fshatra ku gjendja e rrugëve është e mirë (Tozhar, Kapinovë dhe Peshtan)
- 2024 – 2027: do të shihet mundësia e zgjerimit të shërbimit në fshatrat e tjerë ku infrastruktura rrugore do të jetë e përshtatshme

Bashkia Poliçan synon të zgjerojë shërbimin e grumbullimit të mbetjeve në zonat ku nuk ofrohet shërbim, duke filluar me gjetjen e një pike grumbullimi në fshatrat që do t'i shtohen skemës së grumbullimit të mbetjeve. Më pas, Bashkia me anë të një kamioni do të kryejë grumbullimin dhe transportin për në vend depozitimin aktual të mbetjeve apo në stacionin e transferimit në të ardhmen. Ndarja e zonave të grumbullimit në të ardhmen do të zbatohet si më poshtë:

- Zona 1: Qyteti Poliçan
- Zona 2: Fshatrat e NJA Vërtop
- Zona 3: fshatrat e NJA Tërpan

Do të përmirësohet shërbimi duke vendosur kontenierë shtesë aty ku shihet nevoja, por edhe duke shtuar frekuencën e shërbimeve, kryesisht në zonat me popullsi më të madhe (Zona 1 & Zona 2). Mbetjet do të grumbullohen çdo ditë në zonën 1, dy herë / javë në Zonën 2 dhe 1 herë / javë në zonën 3.

Më poshtë paraqiten të dhënat kryesore mbi të cilat llogariten sasitë e mbetjeve dhe propozohet itinerari që mund të kryejë kamioni kompaktor për të zgjeruar shërbimin në fshatrat Peshtan, Tozhar dhe Kapinovë.




Figura 12 Harta e zgjerimit të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale

Fshatrat	Banorë (nr sipas të dhënave të bashki-së	Mbetjet e gjeneruara		Frekuenca e grumbulli-mit	Sasia e mbetjeve për një rrugë të mjetit	Nr i kontenie-rëve të nevojshëm	Distanca nga rruga që përshko-het sot	Distancë shtesë për grumbulli-min e mbetjeve	Kohë shtesë
		kg/pers/d	t/d		t/rrugë	#	km	km	min
Peshtan	380	0.40	0.15	2x/ javë	0.53	5	3	6	29
Kapinovë	400	0.40	0.16	2x/ javë	0.56	5	7	14	41
Tozhar	240	0.40	0.10	1x/ javë	0.67	6	12	24	60
Gjithsej	1,020					16			

Të dhënat bazë:

- Me shërbimin e ofruar aktualisht (itinerari i shënuar me ngjyrë të verdhë në hartë) grumbullohen çdo ditë 3.2 t mbetje (3.8 t sasia e përllogaritur në studimin sektorial për MIM).
- Kamioni teknologjik ka kapacitet maksimal 5 tonë dhe për rrjedhojë i mbetet 1.8 t kapacitet i lirë në çdo rrugë që përshkon, ndaj mund të përdoret për grumbullimin e mbetjeve në 3 fshatrat e rinj.
- Në njësinë Vërtop (fshatrat Peshtan dhe Kapinovë) do të shërbehet 2x/ javë dhe në njësinë Tërpan (fshati Tozhar) 1x/ javë.
- Itinerari i mjetit të grumbullimit kalon përgjatë rrugës nacionale siç paraqitet në hartë (me ngjyrë të verdhë).

Supozime:

- Gjenerimi specifik i mbetjeve është 0.4 kg/person/ditë (Studimi sektorial për MIM)
- Distanca shtesë që përshkohet për grumbullimin është matur nga itinerari kryesor i mjetit drejt secilit nga 3 fshatrat
- Numri i kontenierëve të nevojshëm është llogaritur mbi bazën e normës së mbushjes së tyre prej 50%.
- Distanca mesatare midis kontenierëve brenda një vendbanimi supozohet të jetë 200 m.
- Shpejtësia mesatare e kamionit gjatë ecjes supozohet të jetë 40 km/h
- Shpejtësia e lëvizjes së kamionit nga njëri kontenier tek tjetri supozohet të jetë 5 km/h.

Tabela 10 Itinerari i propozuar për grumbullimin e mbetjeve në zonën e re

Mjeti i grumbullimit	**Zona e grumbullimit**	**E hënë**	**E martë**	**E mërkurë**	**E enjte**	**E premte**	**E shtunë**	**E diel**
Rrugë		**I**	**II**	**III**	**IV**	**II**	**III**	**I**
Kamion kompaktor (5 tonë)	Itinerari aktual i grumbullimit	X	X	X	X	X	X	X
	Peshtan		X			X		
	Kapinovë			X			X	
	Tozhar				X			
	Shkarkimi në vend depozitimin bashkiak							
Sasia e mbetjeve	t/rrugë	3.8	4.3	4.4	4.5	4.3	4.4	3.8
Kohë shtesë	min	0	29	41	60	29	41	0

Llogaritet që do të duhet të shtohen 16 kontenierë të tjerë në këto tre fshatra. Në fshatin Peshtan mjeti do të përshkojë një distancë shtesë prej 3 km nga itinerari i tanishëm dhe 6 km për grumbullimin e mbetjeve nga kontenierët. Koha e kryerjes së këtij shërbimi llogaritet rreth 29 min. Për të ofruar shërbimin në Kapinovë, mjeti do të përshkojë distancën 7 km nga itinerari i tanishëm dhe 14 km të tjerë midis pikave të grumbullimit, për rreth 41 minuta. Në fshatin Tozhar, distanca nga itinerari që ndiqet sot është 12 km dhe 24 km të tjerë përbëjnë distancat midis 6 kontenierëve të propozuar, për t'u përshkuar në një kohë mesatare prej 60 min. Sipas planit të propozuar, përveç rrugëve që përshkon mjeti kompaktor për grumbullimin e mbetjeve çdo ditë, do të shtohet dhe ofrimi i shërbimit në Peshtan 2 herë në javë (të martë, të premte), në Kapinovë 2 herë në javë (të mërkurë, të shtunë) dhe në Tozhar 1 herë në javë (të enjte).








Figura 13 Harta nga Google të rrugëve hyrëse për në Peshtan, Kapinovë dhe Tozhar

Me anë të shtrirjes së shërbimit në fshatrat e tjerë ku mundësohet qarkullimi i mjeteve, synohet që të rritet mbulimi i popullsisë me shërbim, nga 69% në 2022 në 80% në vitin 2027. Ky proces do të shoqërohet me fushata ndërgjegjësimi për eleminimin e mbetjeve bujqësore dhe përfshirjen e tyre në procesin e kompostimit, pasi në dy vitet e fundit këto mbetje kanë krijuar problem në territor.

Masa:

M 1.1.1	Komunikimi dhe dakordësia me kryetarët e fshatrave dhe administratorët e Njësive Administrative
M 1.1.2	Përgatitja e hartës për shërbimin e grumbullimit dhe llogaritja e kostove për zonën e re të zgjeruar të shërbimit
M 1.1.3	Llogaritja e kostove për zonën e re të zgjeruar të shërbimit
M 1.1.4	Diskutimi dhe dakordësia për amendimin e kontratës së shërbimit të pastrimit me kompaninë private të shërbimit
M 1.1.5	Miratimi i buxhetit të ri nga Këshilli Bashkiak
M 1.1.6	Rishikimi i kontratës
M 1.1.7	Shtrirja e shërbimeve në zonat e reja
M 1.1.8	Gjetja e nje pike transferimi në fshatrat ku nuk ka shërbim: Tozhar, NJA Tërpan; Kapinovë, NJA Vërtop

3.3.1.2 Objektivi specifik 1.2: Ngritja e sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve

E përfshirë në Zonën e Menaxhimit të Mbetjeve Berat, Bashkia e Poliçanit do të jetë pjesë e sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve, duke përfituar nga ekonomia e shkallës dhe

investimet që do të kryhen për infrastrukturën rajonale. Pjesëmarrja e bashkisë do të mundësohet nëpërmjet bashkëpunimit ndërbashkiak me bashkitë e tjera të Qarkut Berat. Një strukturë e re rajonale do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e shërbimeve që do të ofrohen në nivel rajonal si transferimi dhe depozitimi i mbetjeve.


Për shkak të distancës së largët nga bashkia Poliçan deri në vend depozitimin e ri sanitar rajonal që është parashikuar të ndërtohet në Bashkinë Dimal, mbetjet e mbledhura do të transferohen fillimisht në një stacion transferimi në Bashkinë Poliçan. Sipas analizës së kryer për kostot e transportit për njësi ton mbetje me mënyra të ndryshme transporti, rezulton që për distanca më të mëdha se 30 km alternativa më ekonomike është ajo e transportimit të mbetjeve nëpërmjet një stacioni transferimi. Për këtë qëllim është identifikuar një vend i përshtatshëm për ndërtimin e stacionit të transferimit.



Figura 14 Vendndodhja e propozuar për stacion transferimi

Transferimi i mbetjeve në ST ndërthurrur me transportin në distancë të largët paraqet disa avantazhe:

- Shfrytëzimi më i mirë i kamionëve të grumbullimit
- Lidhja e vendbanimeve të vogla
- Më pak kosto operative dhe mirëmbajtjeje
- Më pak trafik/ më pak emetime të gazit



Projeksioni i sasisë së mbetjeve që do të grumbullohen në bashkinë Poliçan në vitet e ardhshme fillon me një sasi rreth 3.5 tonë/ditë dhe vjen duke u ulur deri në rreth 3.4 tonë/ditë në vitin 2027. Ky pakësim i sasisë së mbetjeve lidhet me zhvillimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të ricikluesshme dhe mbetjeve të gjelbra si detyrime ligjore.

Në stacionin e transferimit të tipit me rampë dhe pa kompaktim, mbetjet do të shkarkohen nga kamioni kompaktor i grumbullimit në një kontenier të madh me kapacitet 30 m^3. Dendësia e mbetjeve në këto kontenierë parashikohet të jetë 0.4 t/m^3 dhe norma e mbushjes 75%. Pasi kontenieri të jetë mbushur ai do të transportohet nëpërmjet një kamioni me vinç për transferimin e mbetjeve drejt qendrës rajonale të menaxhimit të mbetjeve.

Është llogaritur që do të nevojiten 3 rrugë në javë për të transportuar mbetjet nga stacioni i transferimit të Poliçanit në vend depozitimin sanitar rajonal.




Figura 15 Planimetria e përgjithshme e stacionit të transferimit të propozuar




Figura 16 Koncepti teknik për stacionin e transferimit

Për ndërtimin e vend depozitimit sanitar rajonal janë studiuar disa vende të mundshme pranë qendrës që gjeneron sasinë më të madhe të mbetjeve dhe është përzgjedhur një vend i përshtatshëm në territorin e Bashkisë Dimal. Vend depozitimi do të projektohet për të pritur mesatarisht 27,000 tonë mbetje në vit ose 540,000 tonë mbetje gjithsej gjatë një periudhe 20 vjeçare. Ai do të ndërtohet dhe funksionojë sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni vendas (VKM nr. 389 dhe 452) për vend depozitimet e mbetjeve jo të rrezikshme. Elementët kyç të vend depozitimit sanitar do të jenë

- Bazament i përshtatshëm dhe një shtresë sipërfaqësore,
- Rrethim dhe një portë,
- Një peshore dhe një zyrë për komandimin e peshores,
- Sistem për grumbullimin dhe trajtimin e lëngut kullues,
- Sistem për grumbullimin dhe trajtimin e gazit të vend depozitimit,
- Sistem për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore,
- Mjete të lëvizshme të përshtatshme për proceset e punës,
- Ndërtesë për administratën, stafin operativ dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.

Funksionimi i vend depozitimit rajonal do të organizohet sipas standardeve të Shqipërisë dhe BE për të reduktuar ndikimet mjedisore dhe për të rritur rendimendin e punës, në përputhje me një plan operativ.

Masa:

M 1.2.1	Vendimi i Këshillit Bashkiak për t'u bërë pjesë e një sistemi rajonal për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe për të pasur një Ndërmarrje të përbashkët me bashkitë e tjera
M 1.2.2	Identifikimi i një vendi të përshtatshëm për Stacion Transferimi (ST)
M 1.2.3	Projektimi i stacionit të transferimit, konsultimet publike dhe aplikimi për lejet
M 1.2.4	Zhvillimi i konsultimeve publike për ST
M 1.2.5	Aplikimi për leje mjedisore
M 1.2.6	Aplikimi për leje infrastrukture
M 1.2.7	Ndjekja dhe monitorimi i ndërtimit të stacionit të transferimit
M 1.2.8	Ndjekja dhe monitorimi i funksionimit të stacionit të transferimit
M 1.2.9	Depozitimi i mbetjeve urbane në qendrën rajonale të menaxhimit të mbetjeve

3.3.1.3 Objektivi specifik 1.3: Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të riciklueshme të thata

Mbetje të riciklueshme të thata janë ajo pjesë e mbetjeve të ngurta, të përbëra prej plastikës, letrës/kartonit, qelqit dhe metalit, të cilat mund të përpunohen sërish dhe të shndërrohen në lëndë të parë për industrinë prodhuese. Duke i grumbulluar këto mbetje në mënyrë të diferencuar, pa i përzjerë ato me mbetjet e tjera shtëpiake, synohet që të ruhet cilësia e materialeve dhe për rrjedhojë të sigurohet një nivel më i lartë i rikuperimit të tyre. Riciklimi i këtyre lëndëve paraqet disa avantazhe nga pikëpamja mjedisore dhe ekonomike, si ruajtja e burimeve natyrore dhe kursimi i energjisë në prodhim. Njëkohësisht, ky aktivitet ndihmon për të pakësuar në masë të konsiderueshme sasinë e mbetjeve që prodhohen, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e kostove për transportimin dhe depozitimin e mbetjeve.

Për të prezantuar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme në bashki, do të fillohet me zbatimin e tre projekteve pilot:

1. Në qendër të qytetit Poliçan
2. Në 3 shkolla të bashkisë
3. Në fshatin Fushë Peshtan, NJA Vërtop

Grumbullimi i mbetjeve do të kryhet për 1) mbetje të përziera jo të riciklueshme dhe 2) mbetje të riciklueshme të thata. Për të mundësuar këtë aktivitet do të sigurohen dhe vihen në dispozicion 20 kontenierë 1.1 m^3 metalikë me kapak me ngjyrë të ndryshme. Aktivitetet do të paraprihen dhe shoqërohen me një fushatë informuese dhe ndërgjegjësuese për komunitetet përkatëse. Projekti pilot në qendër të qytetit Poliçan do t'u drejtohet dhe do të kërkojë pjesëmarrjen e angazhimin e qytetarëve që banojnë në qendër, por pa përjashtuar të gjithë qytetarët, duke supozuar që secili mund të kontribuojë duke i çuar mbetjet e riciklueshme të thata në kontenierët e posaçëm. Gjithashtu do të kërkohet mbështetja dhe bashkëpunimi i bizneseve në afërsi për t'u bërë pjesë e skemës për grumbullimin e diferencuar. Bazuar në rezultatet pozitive të nismës pilot, projekti do të shtrihet në një zonë më të madhe.

Aktivitetet në tre shkolla të bashkisë do të zbatohen në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse dhe stafin pedagogjik, të cilët do të angazhohen në edukimin e fëmijëve, dhënien e udhëzimeve dhe monitorimin e situatës në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që kjo nismë të funksionojë. Nëpërmjet ndërgjegjësimit të nxënësve, synohet që mesazhi i ndarjes së mbetjeve në burim dhe zbatimi i kësaj praktike të fillojë edhe në familjet e nxënësve.

Për ta zgjeruar këtë aktivitet edhe në zonat rurale, do të fillohet me fshatin Fushë Peshtan në NJA Vërtop, duke qenë se kushtet e infrastrukturës këtu janë më të përshtatshme dhe mund të sigurohet një sasi e mjaftueshme mbetjesh të thata të riciklueshme.

Për shkak të mungesës së një tregu riciklimi brenda territorit të bashkisë, mbetjet e ricikluеshme të grumbulluara veçmas do të duhet të transportohen në bashkinë Berat ose në Dimal, ku ka një treg të tillë. Duke qenë se parashikohet një sasi e vogël mbetjesh të ricikluеshme, transporti direkt i tyre nuk do të jetë rentabël. Për këtë arsye, këto mbetje të grumbulluara veçmas do të ruhen përkohësisht në një ambient të caktuar, deri sa të arrihet një vëllim i caktuar që mundëson transportin ekonomik. Nëse stacioni i transferimit i planifikuar do të jetë funksional në këtë kohë, do të shihet mundësia që sasitë e grumbulluara të magazinohen përkohësisht në ST.

Këto aktivitete do të ndihmojnë për arritjen e synimeve rajonale e kombëtare lidhur me riciklimin e mbetjeve të ricikluеshme të thata. Konkretisht në Strategjinë Kombëtare MIM synohet që 20% e sasisë së mbetjeve të prodhuara të shkojë për riciklim. Referuar gjendjes ekzistuese të analizuar në qarkun Berat në 2019 (Plani Rajonal), norma e riciklimit vlerësohet të jetë 2.6%, megjithatë është pozitive ndërmarrja e këtyre nismave në shkallë të vogël edhe në bashkinë tonë.

Mbetjet nga ambalazhet janë pjesë e mbetjeve bashkiake të thata të ricikluеshme. Sipas Strategjisë Kombëtare MIM kjo rrymë mbetjesh do të trajtohet veçanërisht nëpërmjet përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Pritet të hartohet një Master Plan për Mbetjet e Ambalazheve, ku do të specifikohen masat, organizimi dhe përgjegjësia financiare për menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve. Në varësi të realizimit të këtij sistemi, bashkia do të bashkëpunojë edhe me sektorin privat për mbledhjen e mbetjeve të ambalazheve.

Masa:

M 1.3.1	Përgatitja e projektit pilot për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të ricikluesshme të thata
M 1.3.2	Miratimi i Kryetarit të Bashkisë
M 1.3.3	Përfshirja e procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në kontratën e shërbimit me operatorin
M 1.3.4	Zbatimi i projektit pilot për ndarjen e mbetjeve në qendrën e qytetit
M 1.3.5	Zbatimi i projektit pilot për ndarjen e mbetjeve në 3 shkolla
M 1.3.6	Caktimi dhe përshtatja e një vendi për magazinimin e përkohshëm të materialeve të ricikluesshme të grumbulluara
M 1.3.7	Blerje e 20 kontenierëve 1.1m^3 metalik, me kapak (10+10 me ngjyra të ndryshme)
M 1.3.8	Sistem grumbullimi i mbetjeve të thata të ricikluesshme në Fushë Peshtan
M 1.3.9	Fushatë ndërgjegjësuese me qytetarët për ndarjen e duhur sipas koshave në zonat pilot
M 1.3.10	Aktivitete ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave

3.3.1.4 Objektivi specifik 1.4: Grumbullimi i diferencuar dhe kompostimi i mbetjeve bio

Mbetjet bio ose organike, sipas përkufizimit të ligjit, janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, kateringu dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve. Ato përmbajnë lëndë organike të cilat në kushte aerobe shpërbëhen dhe formojnë një lëndë të njohur si kompost. Kompostimi paraqet disa avantazhe në aspektin mjedisor, klimatik dhe ekonomik. Së pari, kompostimi është i dobishëm për të menaxhuar në mënyrë të qendrueshme përbërësit kryesorë organikë të mbetjeve dhe për t'i përdorur ato në funksion të aktiviteteve bujqësore. Nga ana tjetër, pakësimi i sasisë së mbetjeve duke larguar rrymën e mbetjeve organike do të reflektohet në kosto më të ulëta transporti dhe depozitimi. Gjithashtu në vend depozitimin e mbetjeve do të ketë më pak lëndë organike që ndikojnë në prodhimin e gazit të vend depozitimit, një gaz serrë me ndikim negativ në ndryshimet klimatike.

Në Strategjinë Kombëtare MIM është caktuar synimi për të kompostuar 20% të mbetjeve të biodegradueshme deri në vitin 2025, por duke marrë parasysh situatën aktuale në vend Plani Rajonal MIM i Qarkut Berat ka synuar realizimin në nivelin 10% deri në 2023 dhe 15% deri në vitin 2028.

Duke zbatuar edhe orientimet e Planit Rajonal, grumbullimi i diferencuar do të fillojë me aktivitete pilot për mbetjet e gjelbra në fshatin Bregas, të njësisë administrative Vërtop.

Aktualisht pranë fshatit Bregas zbatohet nga banorët një praktikë për të mbledhur veçmas mbetjet bujqësore, megjithëse menaxhimi i tyre nuk kryhet siç duhet. Ndaj është menduar që nismat e para për kompostimin në nivel fshati të zhvillohen në Bregas, për t'u bazuar në eksperiencën e fituar tashmë dhe për t'i nxitur banorët ta zhvillojnë më tej këtë aktivitet.

Për kryerjen e kompostimit me anë të metodave të thjeshta do të nevojitet një sipërfaqe toke në një terren të përshtatshëm. Për caktimin e këtij vendi ashtu si dhe për menaxhimin e pikës së kompostimit do të diskutohet dhe arrihet dakordësi me administratorin e NJA dhe kryetarin e fshatit. Është vlerësuar e dobishme blerja e një makinerie grirëse për mbetjet organike të thata, si degët e krasitura të pemëve. Grirja e materialit të drurit në copëza më të vogla do të lehtësojë shpërbërjen e tyre dhe përzierjen me masën e gjelbër të njomë gjatë procesit të kompostimit. Makineria mund të përdoret gjithashtu si një zgjidhje alternative për masën e madhe të mbetjeve organike që krijohet nga krasitja e degëve të ullirit, për të krijuar material të coptuar që fermerët mund ta përdorin për mbulimin e tokës përreth pemëve.

Vlen të theksohet rëndësia e informimit dhe ndërgjegjësimit të banorëve rreth aktivitetit të kompostimit, metodës dhe dobive të tij, në mënyrë që të arrihet mbështetja dhe pjesëmarrja e banorëve në nivel të kënaqshëm.

Masa:

M 1.4.1	Përgatitja e projektit pilot për grumbullimin dhe kompostimin e mbetjeve të gjelbra në Bregas, NJA Vërtop
M 1.4.2	Miratimi i Kryetarit të Bashkisë
M 1.4.3	Caktimi i tokës dhe përshtatja e terrenit për kompostim me sipërfaqe të mjaftueshme në një vend të përshtatshëm
M 1.4.4	Dakordësi për menaxhimin e pikës së kompostimit me fermerët, NJA dhe Kryetarin e fshatit
M 1.4.5	Prokurimi i një makinerie grirëse për mbetjet e gjelbra
M 1.4.6	Zbatimi i projektit pilot të kompostimit
M 1.4.7	Fushatë ndërgjegjësuese me qytetarët për kompostimin e mbetjeve të gjelbra
M 1.4.8	Aktivitete ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave për ndarjen në burim të mbetjeve të gjelbra dhe kompostimin

3.3.1.5 Objektivi specifik 1.5: Pastrimi me cilësi i rrugëve dhe shesheve

Shërbimi i pastrimit të rrugëve dhe shesheve sot ofrohet aty ku është i mundur, si në Poliçan dhe fshatin Mbrakull. Gjatë periudhës së zbatimit të këtij Plani Vendor MIM, shërbimi do të shtrihet edhe në sheshet e reja të dy fshatrave: Fushë Peshtan me sipërfaqe 5,000 m^2 dhe Mbrakull me sipërfaqe 1,000 m^2. Gjithashtu, do të përmirësohet sistemi i monitorimit për

kryerjen e shërbimit duke përfshirë në mënyrë aktive edhe banorët përmes anketimit dhe komunikimeve me zyrën e informacionit të bashkisë.

Masa:

M 1.5.1	Shtrirja e shërbimit në fshatra të tjerë që do të kenë infrastrukturën e duhur
M 1.5.2	Përmirësimi i sistemit të monitorimit për zbatimin e shërbimit, duke rritur edhe pjesëmarrjen e banorëve nëpërmjet zyrës së informacionit dhe anketimit të banorëve

3.3.1.6 Objektivi specifik 1.6: Menaxhimi i integruar mjedisor i mbetjeve inerte

Sot në bashki ka 1 vend të caktuar për depozitimin e mbetjeve inerte në Plirëz. Në këtë vend depozitim grumbullohen dhe depozitohen mbetje inerte si nga familjet ashtu dhe nga subjektet, por parashikohet që mbetjet inerte që gjenerohen nga familjet të grumbullohen veçmas nga ato të gjeneruara nga subjektet.

Aktualisht në Vodicë bizneset që ushtrojnë aktivitetin e përpunimit të pllakave të gurit i depozitojnë mbetjet në një vend informal në afërsi të lumit. Për shkak të ndikimeve negative në mjedis, bashkia do të marrë masa për zgjidhjen e këtij problemi duke siguruar një vend të përshtatshëm për depozitimin e mbetjeve inerte. Ky vend depozitim do të caktohet dhe ngrihet në afërsi të bizneseve të gurit në Vodicë për mbetjet inerte të prodhuara nga ky sektor. Ndërsa vend depozitimi aktual i mbetjeve inerte do të vijojë të funksionojë dhe të mirëmbahet.

Mbetjet inerte që gjenerohen nga përpunimi i gurit dekorativ, do të depozitohen nga vetë banorët apo bizneset. Në rastin e investimeve publike, Bashkia do të kujdeset për depozitimin e duhur të mbetjeve inerte në vend depozitimin e caktuar. Në të ardhmen do të shihet dhe mundësia e blerjes së një makinerie për përpunimin e mbetjeve inerte, çka do të mundësojë rikuperimin e materialit dhe shfrytëzimin e tij sipas nevojave të bashkisë.

Masa:

M 1.6.1	Identifikimi i një vendi të përshtatshëm për depozitimin e mbetjeve inerte në afërsi të bizneseve të gurit
M 1.6.2	Miratimi i Këshillit Bashkiak për vendin e përzgjedhur
M 1.6.3	Studimi për funksionimin e vend depozitimit të mbetjeve inerte me makineri të posaçme për trajtimin e tyre, përfshirë llogaritjen e kostove
M 1.6.4	Aplikimi për leje mjedisore
M 1.6.5	Aplikimi për leje infrastrukture
M 1.6.6	Funksionimi i vend depozitimit të ri të mbetjeve inerte
M 1.6.7	Shfrytëzimi i materialeve inerte të rikuperuara

3.3.1.7 Objektivi specifik 1.7: Menaxhimi i rrymave specifike të mbetjeve

Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike në bashki aktualisht mblidhen nga një individ drejtpërdrejt nga familjet, bizneset apo institucionet. Ky individ paraqitet pothuajse rregullisht për grumbullimin e tyre dhe nëse ka kërkesa njoftohet me telefon.

Përveç këtij grumbullimi informal, zakonisht mbetjet elektrike/ elektronike dhe ato voluminoze hidhen së bashku me mbetjet e përzjera shtëpiake në pikën e grumbullimit, si brenda ashtu edhe jashtë përreth kontenierit. Për këtë arsye, në këtë Plan Vendor MIM parashikohet përmirësimi i gjendjes së pikës së grumbullimit duke pasur një hapësirë specifike të caktuar për mbetjet elektrike/ elektronike dhe mbetjet voluminoze, si orenditë e vjetra.

Gjithashtu do të kryhet një sondazh për mbledhjen e të dhënave rreth gjenerimit dhe grumbullimit të pajisjeve elektronike, si dhe për perceptimin e publikut lidhur me situatën aktuale dhe mënyrat se si mund të përmirësohet.

Masa:

M 1.7.1	Caktimi i një sipërfaqeje të caktuar për mbetjet voluminoze dhe mbetjet elektrike/elektronike pranë një pike grumbullimi, aty ku ka hapësirë
M 1.7.2	Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave për gjenerimin e mbetjeve voluminoze dhe elektrike/elektronike nëpërmjet një sondazhi me pyetësorë

3.3.1.8 Objektivi specifik 1.8: Rehabilitimi i vend depozitimit bashkiak

Vend depozitimi i mbetjeve që përdoret aktualisht nga bashkia do të rehabilitohet dhe do të vazhdojë të përdoret si vend depozitim i kontrolluar derisa të ndërtohet sistemi rajonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe të vihet në punë infrastruktura rajonale (vend depozitimi sanitar dhe stacioni i transferimit). Për këtë qëllim, do të përgatitet një koncept për rehabilitimin e vend depozitimit të mbetjeve, përfshirë aspektet organizative dhe operacionale të tij. Pas rehabilitimit, ky vend depozitim do të përdoret vetëm për një periudhë prej jo më shumë

se 5 vjetësh. Punimet e rehabilitimit do të realizohen me mbështetjen e Këshillit të Qarkut Berat nëpërmjet një projekti të financuar nga BE.



Figura 17 Vend depozitimi aktual i mbetjeve urbane

Masa:

M 1.8.1	Përgatitja e konceptit për rehabilitimin e vend depozitimit
M 1.8.2	Miratimi i konceptit nga Kryetari i Bashkisë
M 1.8.3	Miratimi i buxhetit nga Këshilli Bashkiak
M 1.8.4	Aplikimi për leje
M 1.8.5	Zbatimi i masave rehabilituese

3.3.1.9 Objektivi specifik 1.9: Mbyllja e sigurt dhe me standard e vend depozitimeve të vjetra




Figura 18 Vend depozitimi i vjetër i mbetjeve pranë përroit të Plirzës

Në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Poliçan, do t'i kushtohet vëmendje rehabilitimit dhe mbylljes së vend depozitimeve të vjetra të mbetjeve brenda territorit të bashkisë, bazuar në projekte teknike që garantojnë standardet mjedisore dhe rikthimin e mjedisit në formën e vet. Rehabilitimi i vend depozitimeve të vjetra vjen gjithashtu si rekomandim në raportin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit "Zbutja e riskut në vend depozitime" (2018). Për kohështrirjen e këtij Plani Vendor është parashikuar të paktën rehabilitimi i vend depozitimit të vjetër pranë përroit në Plirëz, i cili është me përmasa më të mëdha dhe ndodhet në zonën ujëmbledhëse të përroit.

Për zbatimin e kësaj mase, fillimisht do të duhet të sigurohet financimi.

Masa:

M 1.9.1	Gjetja dhe aplikimi për financim
M 1.9.2	Hartimi i konceptit për mbylljen e vend depozitimit në Plirëz pranë përroit
M 1.9.3	Miratimi i Kryetarit të Bashkisë
M 1.9.4	Aplikimi për leje
M 1.9.5	Zbatimi i masave për mbylljen e vend depozitimit

3.3.2Zhvillimi organizativ dhe fuqizimi i kapaciteteve

Objektivi strategjik 2:

Krijimi i strukturës funksionale dhe efiçente në bashki për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e performancës së shërbimit, që zhvillon kapacitetet me anë të trajnimeve.

Ky objektiv fokusohet në forcimin e kapaciteteve të stafit për menaxhimin dhe monitorimin e mbetjeve, si edhe në përcaktimin e kuadrit rregullator në bashki për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe forcimin e zbatimit të tij.

3.3.2.1 Objektivi specifik 2.1: Ngritja dhe funksionimi i strukturës bashkiake për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve efektive për MIM

Një nga masat e përfshira në Strategjinë Kombëtare për MIM është "ngritja e zyrës së menaxhimit të mbetjeve si pjesë e strukturës së bashkisë, në nivelin e njësisë në bashkitë e vogla dhe të departamentit në bashkitë e mëdha. Personeli do të përfitojë nga kualifikimet e rregullta, të cilat duhet të planifikohen në buxhetet vjetore të menaxhimit, në mënyrë që të sigurohet qendrueshmëria e funksionimit të sistemit."

Në Bashkinë Poliçan do të merret në shqyrtim mundësia e krijimit të një njësie për menaxhimin e mbetjeve, e cila të jetë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave, të rregulloreve dhe planeve përkatëse. Kjo njësi gjithashtu do të kryejë monitorimin e zbatimit të këtij Plani dhe aktivitetet e parashikuara në të, si dhe vlerësimin e raportimin për nivelin e zbatimit. Ngritja e kësaj njësie do të kërkojë ndarjen dhe caktimin e përgjegjësive për pozicionet që e përbëjnë atë dhe përshkrimet përkatëse.

Masa:

M 2.1.1	Krijimi i një njësie në bashki për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve për menaxhimin e mbetjeve
M 2.1.2	Krijimi i organogramës dhe përcaktimi i përgjegjësive
M 2.1.3	Hartimi i përshkrimeve të punës për pozicionet përkatëse

3.3.2.2 Objektivi specifik 2.2: Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve të bashkisë në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve

Për të siguruar mbarëvajtjen e punës dhe kryerjen e shërbimeve sa më cilësore bashkia do të kujdeset që punonjësit që janë përgjegjës për funksione të ndryshme të menaxhimit të mbetjeve të përfshihen në programe trajnimi dhe kualifikimi në fushën përkatëse. Pjesëmarrja e stafit të bashkisë në një sërë seminaresh të zhvilluara në kuadër të projektit "Menaxhimi i mbetjeve të ngurta në qarkun Berat" ka shërbyer për rritjen e njohurive, veçanërisht lidhur me konceptin e një sistemi rajonal për menaxhimin e mbetjeve dhe njohjen e teknologjive më të përshtatshme për të rritur efiçencën e shërbimit dhe të kostos. Trajnimi dhe kualifikimi i punonjësve është një

proces i vazhdueshëm, ndaj këto masa duhet të zbatohen gjatë gjithë viteve të periudhës së planifikuar.

Masa:

M 2.2.1	Organizimi i kualifikimeve për punonjësit e sektorit bashkiak për MIM
M 2.2.2	Vizita studimore në bashki të tjera
M 2.2.3	Pjesëmarrja në takime e seminare për menaxhimin e mbetjeve

3.3.2.3 Objektivi specifik 2.3: Miratimi i kuadrit rregullator për MIM në Bashkinë Poliçan

Përgatitja e kuadrit rregullator në Bashkinë Poliçan kërkohet jo vetëm në zbatim të Ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, por edhe për të plotësuar një nevojë të bashkisë për rregullimin dhe organizimin sa më të mirë të aktiviteteve që lidhen me menaxhimin e mbetjeve. Në kuadër të projektit të menaxhimit të mbetjeve në qarkun Berat, Bashkia Poliçan ka përfituar ekspertizë ligjore për hartimin e Rregullores së përgjithshme të menaxhimit të mbetjeve. Sipas kërkesave ligjore, bashkia duhet të hartojë rregullore të veçanta edhe për rrymat specifike të mbetjeve (si ato voluminoze, të pajisjeve elektrike dhe elektronike) dhe për mbetjet inerte. Gjithashtu shihet e nevojshme që të forcohet zbatimi i rregullave në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Masa:

M 2.3.1	Hartimi dhe miratimi i Rregullores së përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve
M 2.3.2	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e rrymave specifike
M 2.3.3	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e mbetjeve inerte
M 2.3.4	Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve

3.3.2.4 Objektivi specifik 2.4: Dokumentimi, menaxhimi dhe raportimi i saktë i të dhënave për mbetjet bashkiake për të mundësuar politikëbërje mbi bazë evidencash dhe monitorim efikas të shërbimit

Mbajtja e të dhënave dhe dokumentimi i tyre i vjen në ndihmë analizës për të vlerësuar efiçencën e kostove e cilësinë e shërbimeve dhe për të marrë vendime lidhur me politikat e ardhshme.

Në Strategjinë Kombëtare MIM, të miratuar me VKM nr 418 datë 27.05.2020, është planifikuar si masë “ngritja e sistemit të matjes, menaxhimit dhe raportimit të mbetjeve bashkiake”.

VKM 687 datë 29.7.2015 përcakton rregullat për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave mbi mbetjet. Sipas këtij vendimi, bashkitë ia dërgojnë këto të dhëna Këshillit të Qarkut përkatës, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën. Raportimi në Këshillin e Qarkut për zbatimin e planit vendor të MIM vjen si kërkesë e Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 (Neni 12, pika 5).

Aktualisht në bashki mbahen të dhëna lidhur me rrymat e ndryshme të mbetjeve, të cilat raportohen në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Synohet që baza e të dhënave të përmirësohet dhe të përditësohet dhe pas krijimit të infrastrukturës së duhur të menaxhimit të mbetjeve që do të mundësojë matjen e sasisë së mbetjeve, të saktësohen të dhënat e dokumentuara dhe raportimi i tyre. Po kështu të dhënat e nevojshme do të sigurohen nga një komunikim periodik me zyrën e Tatim Taksave dhe Zyrën e Informacionit të bashkisë.

Masa:

M 2.4.1	Krijimi dhe përditësimi i një baze të dhënash për dokumentimin, analizimin dhe raportimin e statistikave të mbetjeve në nivel bashkie
M 2.4.2	Përdorimi i të dhënave për të analizuar statistikat e mbetjeve
M 2.4.3	Raportimi për statistikat e mbetjeve në Këshillin Bashkiak
M 2.4.4	Komunikimi periodik me Zyrën e Tatim Taksave dhe Zyrën e Informacionit

3.3.3 Qendrueshmëria financiare e shërbimeve të MIM

Objektivi strategjik 3:

Performancë financiare e qendrueshme për ofrimin e shërbimit MIM me standard duke synuar mbulimin e kostos me tarifat.

Financimi i qendrueshëm i sistemit të menaxhimit të mbetjeve është një nga objektivat strategjikë të direktivës së BE dhe njëkohësisht i Strategjisë Kombëtare për MIM, në të cilën kërkohet që bashkitë të përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për këtë shërbim në përputhje me parimin “ndotësi paguan” dhe parimin e “vetëmjaftueshmërisë”. Përmirësimi i shërbimeve dhe zbatimi i standardeve më të larta për rikuperimin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve do të shoqërohet me kosto më të larta. Për të siguruar financim të qendrueshëm të këtyre shërbimeve me standard më të lartë është e domosdoshme që të rritet niveli i tarifave dhe të përmirësohet arkëtimi i tyre.

Sipas Strategjisë Kombëtare MIM, bashkitë:

- Duhet të llogaritin koston e plotë të shërbimit përfshirë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve dhe nevoja financiare shtesë.

- Duhet të llogaritin dhe të faturojnë tarifën e plotë të shërbimit për grumbullimin dhe transportin.
- Duhet të financojnë 100% të kërkesave për investime për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në territorin e tyre administrativ.
- Duhet të caktojnë në buxhet një shumë të mjaftueshme për garancinë financiare për mbylljen e vendgrumbullimit dhe periudhën e kujdesit pas mbylljes.

Për kryerjen e llogaritjeve të kostove të shërbimit, bashkia vepron në përputhje me VKM nr. 319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”

3.3.3.1 Objektivi specifik 3.1: Mbulimi i kostove të shërbimit MIM nga tarifat

Aktualisht, vetëm 70% (2021) e kostove të shërbimeve MIM mbulohen nga tarifa e grumbulluar (48% sipas analizës financiare të kryer në Tetor 2022). Në përputhje me parimin “ndotësi paguan”, synohet që tarifa për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të vijë duke u rritur gradualisht në të ardhmen. Gjithashtu, tarifa do të duhet të përshtatet në lidhje me sistemin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve që do të ketë kosto më të larta depozitimi.

Synohet që deri në vitin 2027, të arrihet niveli 90% i mbulimit të kostove të shërbimit. Dhe të rritet norma mesatare e arkëtimit të shumës së faturuar deri në 80% për familjet dhe 100% për bizneset. Niveli i tarifave në vitet në vijim do të përcaktohet bazuar në një analizë financiare duke zbatuar parimet bazë të lartpërmendura, ashtu si edhe parimin e përballueshmërisë financiare nga ana e banorëve.

Masat:

M 3.1.1	Studimi i nivelit të tarifave për ndryshimin e tarifës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në bazë të parimit "ndotësi paguan"
M 3.1.2	Miratimi nga Këshilli Bashkiak

3.3.3.2 Objektivi specifik 3.2: Ngritja e një sistemi efiçent dhe transparent për mbledhjen e tarifave

Për të pasur një sistem më efiçent për mbledhjen e tarifave, ashtu siç rekomandohet edhe nga ekspertët e financës së projektit, do të diskutohet dhe lidhet një marrëveshje midis bashkisë Poliçan dhe ndërmarrjes së ujësjellës kanalizimeve për ta përfshirë tarifën e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në faturën e furnizimit me ujë. Kjo masë pritet të përmirësojë ndjeshëm nivelin e arkëtimit të tarifës, pasi do të lidhet me një shërbim të rëndësishëm dhe jetik, i cili nuk duhet të mungojë për banorët dhe bizneset. Përfshirja e tarifës së pastrimit në faturën e furnizimit me ujë do të rritë njëkohësisht informimin e banorëve rreth nivelit të tarifës. Takime me komunitetin e 3 njësive administrative do të shërbejnë gjithashtu për rritjen e informimit rreth kostove të shërbimit dhe nevojave për të rritur mbulimin e tyre.

Masat:

M 3.2.1	Përfshirja e tarifës për menaxhimin e mbetjeve në faturën e tarifës së furnizimit me ujë
M 3.2.2	Informimi i qytetarëve rreth kostove të shërbimit nëpërmjet takimeve në 3 NJA

3.3.4 Informimi, pjesëmarrja dhe ndërgjegjësimi i publikut

Objektivi strategjik 4:

Ndërgjegjësimi i komunitetit me ndjenjën e pronësisë dhe përgjegjësisë për mbetjet që krijon, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të të gjitha grupeve komunitare.

Ndërgjegjësimi është komponenti kyç për të siguruar bashkëpunimin dhe përfshirjen e komunitetit në nismat e reja të bashkisë për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe për t'iu përgjigjur kërkesave ligjore lidhur me menaxhimin e integruar të mbetjeve. Rritja e ndërgjegjësimit vjen si një stad më i lartë i informimit dhe të kuptuarit të një çështjeje të veçantë dhe krijon kushtet për ndryshimin e sjelljes së njerëzve. Njëkohësisht komunikimi i vazhdueshëm me komunitetin është një mënyrë për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë që bashkia duhet të demonstrojë ndaj komunitetit të Poliçanit.

3.3.4.1 Objektivi specifik 4.1: Informimi dhe edukimi i qytetarëve

Qytetarët do të informohen dhe edukohen më shumë rreth rëndësisë së shërbimeve të integruara për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe kostot që lidhen me to. Për këtë qëllim, do të ndërmerren fushata informuese dhe ndërgjegjësuese. Informacioni do të jepet nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të bashkisë dhe platformave të medias sociale që administrohen nga bashkia e Poliçanit. Fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit do të fillojnë të zbatohen në shkolla, dhe institucione, me ndihmën e anëtarëve të këshillit bashkiak.

Në fokus do të jetë gjithashtu edukimi i fëmijëve dhe të rinjve me synim ndryshimin e sjelljes, duke filluar nga ambientet e shkollës dhe duke ndikuar më tej në familje dhe komunitet. Realizimi i aktiviteteve me nxënësit do të bëhet në bashkëpunim me Zyrën Arsimore dhe stafin pedagogjik të shkollave. Në bashkinë Poliçan nuk ka të regjistruara organizata jofitimprurëse, por bashkia do të jetë e hapur të bashkëpunojë me OJF-të që ushtrojnë aktivitetin e tyre në rajonin e Beratit apo më gjerë për zhvillimin e aktiviteteve me fokus informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve rreth çështjes së menaxhimit të mbetjeve. Ndërkohë, Qendra Kulturore e Fëmijëve do të vazhdojë të mbështesë fushatat ndërgjegjësuese me pjesëmarrjen e vetë fëmijëve.

Masa:

M 4.1.1	Fushatë informuese në media lokale
M 4.1.2	Krijimi i posterave me mesazhe ndërgjegjësuese për mbajtjen pastër të mjedisit, përdorimin e koshave
M 4.1.3	Krijimi i klubeve mjedisore në shkolla

3.3.4.2 Objektivi specifik 4.2: Rritja e angazhimit të qytetarëve në aktivitetet e mbajtjes pastër të bashkisë

Aktivitetet për pastrimin e territorit nuk janë konceptuar thjesht si angazhime të punonjësve të bashkisë, të cilët e kanë për detyrë pastrimin e territorit të bashkisë. Nëpërmjet tyre synohet që të arrihet pjesëmarrja dhe angazhimi i vetë qytetarëve, gjë e cila do të ketë një vlerë të madhe ndërgjegjësuese dhe do të japë një mesazh të fortë pozitiv edhe për qytetarët e tjerë. Këto aktivitete do të zhvillohen si pjesë të fushatave kombëtare dhe botërore të pastrimit, si “Të pastrojmë Shqipërinë”, Dita Botërore e Pastrimit, Dita e Tokës, etj dhe mund të shoqërohen me përcjelljen e mesazheve pro-mjedisore në median lokale.

Masa:

M 4.2.1	Aktivitet me pjesëmarrjen e komunitetit për pastrimin e një zone të caktuar me rastin e Ditës Botërore të Tokës (22 Prill), Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit (5 Qershor)
M 4.2.2	Aktivitet me pjesëmarrjen e komunitetit për pastrimin e një zone të caktuar me rastin e Ditës Botërore të Pastrimit (javën e tretë të Shtatorit)
M 4.2.3	Aktivitet pastrimi me pjesëmarrjen e komunitetit në kuadër të fushatës "Të pastrojmë Shqipërinë" (muaji Nëntor)

3.3.4.3 Objektivi specifik 4.3: Pjesëmarrja e publikut në proceset e vendimmarrjes lidhur me MIM

Për të siguruar transparencë në proceset e vendimmarrjes Bashkia Poliçan do të përfshijë gjerësisht komunitetin gjatë hartimit të rregullores së përgjithshme bashkiake për menaxhimin e mbetjeve, si edhe rregulloreve për menaxhimin e mbetjeve inerte dhe rrymave specifike (Neni 12, Ligji 10463/ 2011). Takimet me komunitetin dhe bizneset do të zhvillohen me qëllim informimin e opinionit publik në lidhje me rregulloret, si dhe marrjen e komenteve dhe rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tyre.

Duke qenë se shërbimet e menaxhimit të mbetjeve kërkojnë që qytetarët të ndërveprojnë dhe të integrohen brenda sistemit, është e rëndësishme njohja dhe marrja në konsideratë e nevojave dhe kërkesave specifike të tyre.

Edhe vetë draft dokumenti i Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Poliçan ka qenë subjekt i konsultimeve me publikun, sipas kërkesave ligjore.

Masa:

M 4.3.1	Zhvillimi i konsultimit publik për hartimin e dokumentit PVMIM
M 4.3.2	Zhvillimi i konsultimit publik për hartimin e Rregullores bashkiake të menaxhimit të mbetjeve
M 4.3.3	Zhvillimi i takimeve konsultuese me komunitetin dhe bizneset për hartimin e Rregullores bashkiake për menaxhimin e mbetjeve inerte
M 4.3.4	Zhvillimi i takimeve konsultuese me komunitetin dhe bizneset për hartimin e Rregullores bashkiake për menaxhimin e rrymave të tjera specifike

3.3.5 Shmangia dhe reduktimi i mbetjeve

Objektivi strategjik 5:

Parandalimi dhe reduktimi i mbetjeve në burim

Në Bashkinë Poliçan aktualisht kryhet kompostimi familjar nga vetë banorët kryesisht në zonat rurale dhe praktikohet ripërdorimi i sendeve. Duke e trajtuar menaxhimin e mbetjeve sipas konceptit rajonal, ku mbetjet e bashkisë Poliçan do të depozitohen në vend depozitimin rajonal, është në interes të bashkisë të pakësohet sa më shumë sasia e mbetjeve që do të transportohen dhe depozitohen. Distanca e largët e bashkisë sonë do të rrisë koston e transportit, por do të mund të ulim koston e depozitimit, duke depozituar sa më pak mbetje.

Në këtë mënyrë do të zbatohet parimi i hierarkisë së mbetjeve dhe do të veprohet në përputhje me Nenin 14 të Ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, pika 4, sipas të cilit *“Planet vendore të MIM hartohen në përputhje me të gjitha programet përkatëse për parandalimin e mbetjeve”*.

3.3.5.1 Objektivi specifik 5.1: Kompostimi i mbetjeve të biodegradueshme brenda oborreve në zonat rurale

Në zonat rurale, kompostimi i mbetjeve të biodegradueshme brenda kopshteve apo bashtave të shtëpive është tashmë një praktikë e njohur. Ndaj, në fokus të këtij objektivi specifik do të jetë rritja e cilësisë së kompostit të prodhuar në shtëpi. Familjet do të informohen më shumë rreth

lëndës së përshtatshme organike dhe praktikave të thjeshta të trajtimit. Kjo mund të realizohet me anë të shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe takimeve informuese.

Të gjithë qytetarët dhe bizneset në fshat do të inkurajohen dhe do të edukohen të shmangin mbetjet organike nga sistemi i menaxhimit. Zbatimi masiv i një politike të tillë do të reduktonte me 40–50% sasinë e mbetjeve urbane, por duke pasur parasysh kushtet aktuale dhe nivelin e ndërgjegjësimit, objektivi i synuar deri në vitin 2027 është reduktimi me 15% i sasisë së mbetjeve të biodegradueshme.

Do të nxitet kompostimi individual ose në shkallë të vogël i organizuar mbi bazën e familjes fermere (ose grup familjesh) duke caktuar nga 1.25 m^2 deri në 1.5 m^2 sipërfaqe të oborrit ose tokës pronë e familjes për realizimin e kompostimit. Bashkia do t'i mbështesë fermerët me metodologjinë e duhur për të trajtuar mbetjet:

- Pleh organik
- Kashtë misri
- Mbetje nga krasitjet
- Mbetje perimesh
- Mbetje bar i thatë
- Jonxhë
- Silazh
- Mbetjet e kuzhinës shtëpiake

Mënyra alternative të kompostimit individual

Në lidhje me trajtimin e degëve të krasitura nga pemët e ullirit sugjerohet një qasje me faza:

Hapi 1: grumbullimi i degëve në anë të rrugës pranë ullishtave, bashtave

Hapi 2: grirja/ coptimi i degëve me anë të një makinerie grirëse të lëvizshme, të tërhequr nga një kamion i vogël ose traktor.

Hapi 3: përdorimi i materialit të coptuar

Ka disa mënyra dhe teknika për të shfrytëzuar këtë material organik të thatë:

- për të mbuluar tokën poshtë pemëve, në mënyrë që të mos rriten barëra të këqija,
- si material për mbulimin e lulishteve ose këndeve të lojrave,
- të paketuar në qese për shitje tek pronarët e shtëpive private si material mbulimi për kopshtet e tyre.

- për t'u përzjerë me mbetje të njoma nga perimet ose mbetjet organike shtëpiake si material strukturor për procesin e kompostimit,
- për t'u presuar në briketa që mund të përdoren për djegie në sobat me dru,
- të karbonizuar në njësi pirolize për të prodhuar pluhur ose briketa qymyri për djegie në soba ose në zgara.

Përdorimi i materialit direkt në vendin e prodhimit do të ishte me interes për vetë fermerët.

Masa:

M 5.1.1	Takime me banorët e fshatrave rreth mbetjeve organike dhe procesit të kompostimit
M 5.1.2	Identifikimi i banorëve që janë të interesuar të kryejnë kompostimin
M 5.1.3	Prodhimi i 2 arkave kompostimi për shkollën e bashkuar, fshati Mbrakull dhe për shkollën e fshatit Tomorr i Madh
M 5.1.4	Monitorimi i procesit dhe promovimi i rezultateve
M 5.1.5	Informimi i fermerëve mbi metodologjinë e kompostimit në shtëpi

3.3.5.2 Objektivi specifik 5.2: Parandalimi i mbetjeve nëpërmjet ripërdorimit

Për të reduktuar sasitë e mbetjeve në nivele të kënaqshme dy janë fazat kryesore ku duhet të ndalemi:

1. *Shmangia*

Shmangia e gjenerimit të mbetjeve kërkon që qytetarët të jenë të vetëdijshëm për zgjedhjet e tyre konsumatore dhe të refuzojnë blerjen apo përdorimin e sendeve a ambalazheve që do të krijonin mbetje të tepërta. Për këtë është e nevojshme një fushatë e gjerë ndërgjegjësuese kundër përdorimit të sendeve plastike me një përdorim, qeseve plastike dhe ambalazheve të panevojshme.

2. *Ripërdorimi i materialeve*

Në Poliçan është e lartë mundësia e ripërdorimit të materialeve, si për shembull shishet plastike, shishet e qelqit, kavanozët dhe enët, rrobat e vjetra, materialet e ndryshme të paketimit, druri dhe gomat. Të diktuar edhe nga kushtet ekonomike, qytetarët e praktikojnë gjerësisht ripërdorimin dhe njohin rëndësinë e tij nga pikëpamja ekonomike. Ata ripërdorin shishet për të mbajtur ujin apo qumështin, ose enë qelqi për përdorime shtëpiake. I vetmi produkt paketimi që mund të përdoret më pak janë qeset e holla plastike, përdorimi i të cilave

tashmë është ndaluar me ligj që prej korrikut 2022. E rëndësishme është edhe të rritet jetëgjatësia e produkteve që përdorim nëpërmjet mirëmbajtjes dhe riparimeve.

Për të gjetur zbatim sa më të gjerë, krahas informimit dhe ndërgjegjësimit do të ndërmerren aktivitete që përfshijnë vetë qytetarët dhe nxënësit e shkollave dhe që kërkojnë kontributin e tyre për një kauzë solidariteti.

Masa:

M 5.2.1	Grumbullimi i sendeve të përdorura (veshje, orendi, lodra, libra) në gjendje të mirë për t'u dhuruar tek familjet në nevojë
M 5.2.2	Promovimi i çantave prej cohe të prodhuara nga veshjet e përdorura (xhinse), aktivitet me nxënësit e shkollave
M 5.2.3	Promovimi i punës së shërbimeve të riparimit (këpucar, rrobaqepës, marangoz, elektroshtepiake, etj.)
M 5.2.4	Fushatë ndërgjegjësuese mbi parandalimin e mbetjeve (plastike me një përdorim, ambalazhe të tepërta)

4 Plani i Veprimit, treguesit matës dhe përllogaritjet e kostove

Tabela 11 Plani i Veprimit gjatë periudhës së planifikuar 2022–2027

Objektiva strategjikë		Objektiva specifikë	Masat		Periudha kohore					
					2022	2023	2024	2025	2026	2027
OS1	**Përmirësimi i shërbimeve MIM në Bashkinë Poliçan nëpërmjet teknologjive bashkëkohore, duke nxitur ndarjen në burim.**	**1.1 Shtrirja e shërbimit të MIM në territorin e bashkisë**	1.1.1	Komunikimi dhe dakordësia me kryetarët e fshatrave dhe administratorët e Njësive Administrative						
			1.1.2	Përgatitja e hartës për shërbimin e grumbullimit, llogaritja e kostove për zonën e re të zgjeruar të shërbimit						
			1.1.3	Llogaritja e kostove për zonën e re të zgjeruar të shërbimit						
			1.1.4	Diskutimi dhe dakordësia për amendimin e kontratës së shërbimit të pastrimit me kompaninë private të shërbimit						
			1.1.5	Miratimi i buxhetit të ri nga Këshilli Bashkiak						
			1.1.6	Rishikimi i kontratës						
			1.1.7	Shtrirja e shërbimeve në zonat e reja						
			1.1.8	Gjetja e nje pike transferimi në fshatrat ku nuk ka shërbim: Tozhar, NJA Tërpan, Kapinovë, NJA Vërtop						
		1.2 Ngritja e sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve	1.2.1	Vendimi i Këshillit Bashkiak për t'u bërë pjesë e një sistemi rajonal për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe për të pasur një Ndërmarrje të përbashkët me bashkitë e tjera						
			1.2.2	Identifikimi i një vendi të përshtatshëm për stacion transferimi (ST)						
			1.2.3	Projekti i stacionit të transferimit						
			1.2.4	Zhvillimi i konsultimeve publike për ST						
			1.2.5	Aplikimi për leje mjedisore						
			1.2.6	Aplikimi për leje infrastrukture						

Objektiva strategjikë	Objektiva specifikë	Masat		Periudha kohore					
				2022	2023	2024	2025	2026	2027
		1.2.7	Ndjekja dhe monitorimi i ndërtimit të stacionit të transferimit						
		1.2.8	Ndjekja dhe monitorimi i funksionimit të stacionit të transferimit						
		M 1.2.9	Depozitimi i mbetjeve urbane në qendrën rajonale të menaxhimit të mbetjeve						
	1.3 Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të ricikluesshme të thata	M 1.3.1	Përgatitja e projektit pilot për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të ricikluesshme të thata						
		M 1.3.2	Miratimi i Kryetarit të Bashkisë						
		1.3.3	Përfshirja e procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në kontratën e shërbimit me operatorin						
		1.3.4	Zbatimi i projektit pilot për ndarjen e mbetjeve në qendrën e qytetit						
		1.3.5	Zbatimi i projektit pilot për ndarjen e mbetjeve në 3 shkolla						
		1.3.6	Caktimi dhe përshtatja e një vendi për magazinimin e përkohshëm të materialeve të ricikluesshme të grumbulluara						
		1.3.7	Blerje e 20 kontenierëve 1.1m3 metalik, me kapak (10+10 me ngjyra të ndryshme)						
		1.3.8	Sistem grumbullimi i mbetjeve të thata të ricikluesshme në Fushë Peshtan						
		1.3.9	Fushatë ndërgjegjësuese me qytetarët për ndarjen e duhur sipas koshave në zonat pilot						
		1.3.10	Aktivitete ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave						
	1.4 Grumbullimi i diferencuar dhe kompostimi i mbetjeve të gjelbra	1.4.1	Përgatitja e projektit pilot për grumbullimin dhe kompostimin e mbetjeve të gjelbra në Bregas, NJA Vërtop						
		1.4.2	Miratimi i Kryetarit të Bashkisë						
		1.4.3	Caktimi i tokës dhe përshtatja e terrenit për kompostim me sipërfaqe të mjaftueshme në një vend të përshtatshëm						

Objektiva strategjikë	Objektiva specifikë	Masat		Periudha kohore					
				2022	2023	2024	2025	2026	2027
		1.4.4	Dakordësi për menaxhimin e pikës së kompostimit me fermerët, NJA dhe Kryetarin e fshatit						
		1.4.5	Prokurimi i një makinerie grirëse për mbetjet e gjelbra						
		1.4.6	Zbatimi i projektit pilot të kompostimit						
		1.4.7	Fushatë ndërgjegjësuese me qytetarët për kompostimin e mbetjeve të gjelbra						
		1.4.8	Aktivitete ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave për ndarjen në burim të mbetjeve të gjelbra dhe kompostimin						
	1.5 Pastrimi me cilësi i rrugëve dhe shesheve	1.5.1	Shtrirja e shërbimit në fshatra të tjerë që do të kenë infrastrukturën e duhur						
		1.5.2	Përmirësimi i sistemit të monitorimit për zbatimin e shërbimit, duke rritur edhe pjesëmarrjen e banorëve nëpërmjet zyrës së informacionit dhe anketimit të banorëve						
	1.6 Menaxhimi i integruar mjedisor i mbetjeve inerte	1.6.1	Identifikimi i një vendi të përshtatshëm për depozitimin e mbetjeve inerte në afërsi të bizneseve të gurit						
		1.6.2	Miratimi i Këshillit Bashkiak për vendin e përzgjedhur						
		1.6.3	Studimi për funksionimin e vend depozitimit të mbetjeve inerte me makineri të posaçme për trajtimin e tyre, përfshirë llogaritjen e kostove						
		1.6.4	Aplikimi për leje mjedisore						
		1.6.5	Aplikimi për leje infrastrukture						
		1.6.6	Funksionimi i vend depozitimit të ri të mbetjeve inerte						
		1.6.7	Shfrytëzimi i materialeve inerte të rikuperuara						
	1.7 Menaxhimi i rrymave	1.7.1	Caktimi i një sipërfaqeje të caktuar për mbetjet voluminoze dhe mbetjet elektrike/elektronike pranë një pike grumbullimi, aty ku ka hapësirë						

Objektiva strategjikë		Objektiva specifikë	Masat		Periudha kohore					
					2022	2023	2024	2025	2026	2027
		specifike të mbetjeve	1.7.2	Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave për gjenerimin e mbetjeve voluminoze dhe elektrike/elektronike nëpërmjet një sondazhi me pyetësorë						
		1.8 Rehabilitimi i vend depozitimit bashkiak	1.8.1	Përgatitja e konceptit për rehabilitimin e vend depozitimit						
			1.8.2	Miratimi i konceptit nga Kryetari i Bashkisë						
			1.8.3	Miratimi i buxhetit nga Këshilli Bashkiak						
			1.8.4	Aplikimi per leje						
			1.8.5	Zbatimi i masave rehabilituese						
		1.9 Mbyllja e sigurt dhe me standard e vend depozitimeve të vjetra	1.9.1	Gjetja dhe aplikimi për financim						
			1.9.2	Hartimi i konceptit për mbylljen e vend depozitimit në Plirëz pranë përroit						
			1.9.3	Miratimi i Kryetarit të Bashkisë						
			1.9.4	Aplikimi për leje						
			1.9.5	Zbatimi i masave për mbylljen e vend depozitimit						
OS2	**Krijimi i strukturës funksionale dhe efiçente në bashki për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e performancës së shërbimit, që zhvillon kapacitetet me anë të trajnimeve.**	**2.1 Ngritja dhe funksionimi i strukturës bashkiake për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve efektive për MIM**	2.1.1	Krijimi i një njësie në bashki për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve për menaxhimin e mbetjeve						
		2.2 Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve të bashkisë në lidhje me menaxhimin e	2.2.1	Organizimi i kualifikimeve për punonjësit e sektorit bashkiak për MIM						
			2.2.2	Vizita studimore në bashki të tjera						
			2.2.3	Pjesëmarrja në takime e seminare për menaxhimin e mbetjeve						

Objektiva strategjikë		Objektiva specifikë	Masat		Periudha kohore					
					2022	2023	2024	2025	2026	2027
		integruar të mbetjeve.								
		2.3 Miratimi i kuadrit rregullator për MIM në Bashkinë Poliçan	2.3.1	Hartimi dhe miratimi i Rregullores së përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve						
			2.3.2	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e rrymave specifike						
			2.3.3	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e mbetjeve inerte						
			2.3.4	Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve						
		2.4 Dokumentimi, menaxhimi dhe raportimi i saktë i të dhënave për mbetjet bashkiake për të mundësuar politikëbërje mbi bazë evidencash dhe monitorim efikas të shërbimit	2.4.1	Krijimi dhe përditësimi i një baze të dhënash për dokumentimin, analizimin dhe raportimin e statistikave të mbetjeve në nivel bashkie						
			2.4.2	Komunikimi periodik me Zyrën e Tatim Taksave dhe Zyrën e Informacionit						
OS3	**Performancë financiare e qendrueshme për ofrimin e shërbimit MIM me standard duke synuar**	**3.1 Mbulimi i kostove të shërbimit MIM nga tarifat**	3.1.1	Studimi i nivelit të tarifave për ndryshimin e tarifës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në bazë parimit "ndotësi paguan"						
			3.1.2	Miratimi nga Këshilli Bashkiak						
		3.2 Ngritja e një	3.2.1	Përfshirja e tarifës për menaxhimin e mbetjeve në faturën e tarifës së furnizimit me ujë						

Objektiva strategjikë		Objektiva specifikë	Masat		Periudha kohore					
					2022	2023	2024	2025	2026	2027
	mbulimin e kostos me tarifat.	**sistemi efiçent dhe transparent për mbledhjen e tarifave**	3.2.2	Informimi i qytetarëve rreth kostove të shërbimit nëpërmjet takimeve në 3 NJA						
OS4	**Ndërgjegjësimi i komunitetit me ndjenjën e pronësisë dhe përgjegjësisë për mbetjet që krijon, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të të gjitha grupeve komunitare.**	**4.1 Informimi dhe edukimi i qytetarëve rreth kujdesit për mjedisin dhe ndarjen në burim**	4.1.1	Fushatë informuese në media lokale						
			4.1.2	Krijimi i posterave me mesazhe ndërgjegjësuese për mbajtjen pastër të mjedisit, përdorimin e koshave						
			4.1.3	Krijimi i klubeve mjedisore në shkolla						
			4.1.4	Fushatë ndërgjegjësuese me qytetarët rreth parandalimit të mbetjeve (mospërdorimin e qeseve plastike, enëve me një përdorim, ambalazheve të tepërta, etj.)						
		4.2 Rritja e angazhimit të qytetarëve në aktivitetet e mbajtjes pastër të bashkisë	4.2.1	Aktivitet me pjesëmarrjen e komunitetit për pastrimin e një zone të caktuar me rastin e Ditës Botërore të Tokës (22 Prill), Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit (5 Qershor)						
			4.2.2	Aktivitet me pjesëmarrjen e komunitetit për pastrimin e një zone të caktuar me rastin e Ditës Botërore të Pastrimit (javën e tretë të Shtatorit)						
			4.2.3	Aktivitet pastrimi me pjesëmarrjen e komunitetit në kuadër të fushatës "Të pastrojmë Shqipërinë" (muaji Nëntor)						
		4.3 Pjesëmarrja e publikut në proceset e vendimmarrjes lidhur me MIM	4.3.1	Zhvillimi i konsultimit publik për hartimin e dokumentit PVMIM						
			4.3.2	Zhvillimi i konsultimit publik për hartimin e Rregullores bashkiake të menaxhimit të mbetjeve						
			4.3.3	Zhvillimi i takimeve konsultuese me komunitetin dhe bizneset për hartimin e Rregullores bashkiake për menaxhimin e mbetjeve inerte						
			4.3.4	Zhvillimi i takimeve konsultuese me komunitetin dhe bizneset për hartimin e Rregullores bashkiake për menaxhimin e rrymave të tjera specifike						

Objektiva strategjikë		Objektiva specifikë	Masat		Periudha kohore					
					2022	2023	2024	2025	2026	2027
OS5	Parandalimi dhe reduktimi i mbetjeve në burim	5.1 Kompostimi i mbetjeve të biodegradueshme brenda oborreve të shtëpive në zonat rurale	5.1.1	Takime me banorët e fshatrave rreth mbetjeve organike dhe procesit të kompostimit						
			5.1.2	Identifikimi i banorëve që janë të interesuar të kryejnë kompostimin						
			5.1.3	Prodhimi i 2 arkave për kompostimin për shkollën e bashkuar në fshatin Mbrakull dhe për shkollën e fshatit Tomorr i Madh						
			5.1.4	Monitorimi i procesit dhe promovimi i rezultateve						
			5.1.5	Informimi i fermerëve mbi metodologjinë e kompostimit në shtëpi						
		5.2 Parandalimi i mbetjeve nëpërmjet ripërdorimit	5.2.1	Grumbullimi i sendeve të përdorura (veshje, orendi, lodra, libra) në gjendje të mirë për t'u dhuruar tek familjet në nevojë						
			5.2.2	Promovimi i çantave prej cohe të prodhuara nga veshjet e përdorura (xhinse), aktivitet ne shkolla.						
			5.2.3	Promovimi i punës së shërbimeve të riparimit (këpucar, rrobaqepës, marangoz, elektroshtepiake, etj.)						

Tabela 12 Treguesit matës për arritjen e objektivave të Planit

Objektiva strategjikë		Objektiva specifikë		Tregues matës	Pikënisja 2022	Shënjestra 2027
OS1	**Përmirësimi i shërbimeve MIM në Bashkinë Poliçan nëpërmjet teknologjive bashkëkohore, duke nxitur ndarjen në burim.**	**1.1 Shtrirja e shërbimit të MIM në territorin e bashkisë**	1	Mbulimi (i popullsisë) me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve	69%	80%
			2	Norma e grumbullimit të mbetjeve të prodhuara	72%	80%
		1.2 Ngritja e sistemit rajonal të menaxhimit të mbetjeve	1	Marrëveshje ndërbashkiake me bashkitë e tjera të Qarkut Berat		po
			2	Krijimi i një subjekti për menaxhimin e mbetjeve në nivelin rajonal		po
		1.3 Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të ricikluesshme të thata	1	Sasia e mbetjeve të ricikluesshme që shkojnë për riciklim kundrejt sasisë totale që gjenerohet	2%	30%
			2	Mbulimi me shërbim MIM në zonat urbane (grumbulllimi i diferencuar)	0%	30%
		1.4 Grumbullimi i diferencuar dhe kompostimi i mbetjeve të gjelbra	1	Sasia e reduktuar e mbetjeve të biodegradueshme krahasuar me nivelin në 2016 (në %)	100%	85%
		1.5 Pastrimi me cilësi i rrugëve dhe shesheve	1	Sipërfaqet e hapësirave publike që fshihen (m2)	33,000	39,000
		1.6 Menaxhimi i integruar mjedisor i mbetjeve inerte	1	Sasia e mbetjeve inerte të dërguara në vend depozitim të caktuar nga bashkia (tonë)	70	70
		1.7 Menaxhimi i rrymave specifike të mbetjeve	1	Pika grumbullimi për mbetjet e rrymave specifike	0	1
		1.8 Rehabilitimi i vend depozitimit bashkiak	1	Funksionimi dhe mirëmbajtja e një vend depozitimi të kontrolluar për mbetjet urbane në bashkinë Poliçan		po
			1	Vend depozitime të vjetra të mbyllura		1

Objektiva strategjikë		Objektiva specifikë		Tregues matës	Pikënisja 2022	Shënjestra 2027
		1.9 Mbyllja e sigurt dhe me standard e vend depozitimeve të vjetra	2	Sasia e mbetjeve që depozitohen në vend depozitim të kontrolluar ose vend depozitim sanitar kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara (%)	0%	80%
OS2	**Krijimi i strukturës funksionale dhe efiçente në bashki për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e performancës së shërbimit, që zhvillon kapacitetet me anë të trajnimeve.**	**2.1 Ngritja dhe funksionimi i strukturës bashkiake për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve efektive për MIM**	1	Ngritja dhe funksionimi i zyrës bashkiake për politikat dhe shërbimet e MIM		po
		2.2 Zhvillimi i kapaciteteve të punonjësve të bashkisë në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve.	1	Punonjësit përgjegjës për MIM të aftësuar përmes trajnimeve për ushtrimin me efektivitet të detyrave		80%
			2	Numri i personelit administrativ të punësuar me kohë të plotë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	2	3
		2.3 Miratimi i kuadrit rregullator për MIM në Bashkinë Poliçan	1	Rregullore e miratuar për mbetjet bashkiake		po
			2	Rregullore e miratuar për menaxhimin e rrymave specifike		po
			3	Rregullore e miratuar për menaxhimin e mbetjeve inerte		po
		2.4 Dokumentimi, menaxhimi dhe raportimi i saktë i të dhënave për mbetjet bashkiake për të mundësuar politikëbërje mbi bazë evidencash dhe monitorim efikas të shërbimit	1	Raportimi periodik mbi rrymat e mbetjeve bashkiake		po
			2	Baza e të dhënave për menaxhimin e mbetjeve		po
OS3	**Performancë financiare e qendrueshme për ofrimin e shërbimit MIM me standard duke synuar mbulimin e kostos me tarifat.**	**3.1 Mbulimi i kostove të shërbimit MIM nga tarifat**	1	% e mbulimit të kostove të shërbimit MIM nga të ardhurat e tarifave	70% (2021) 48% (2022)	90%
			2	% e kostos së shërbimit MIM të tarifuar tek bizneset, qytetarët, institucionet	62% (2022)	80%

Objektiva strategjikë		Objektiva specifikë		Tregues matës	Pikënisja 2022	Shënjestra 2027
			3	Buxheti i alokuar për shërbimet MIM kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuara nga bashkia (Lekë shpenzime për 1 tonë mbetje të menaxhuara, kontrata)	11,425 (2021) 16,940 (2022)	15,950
		3.2 Ngritja e një sistemi efiçent dhe transparent për mbledhjen e tarifave	1	% e tarifave të mbledhura në zonën e shërbimit kundrejt shumës së faturuar	78% (2022)	80%
			2	% e familjeve paguese të tarifës MIM në zonën e shërbimit kundrejt atyre të tarifuara	52% (2021) 23% (2022)	80%
			3	% e bizneseve dhe institucioneve paguese të tarifës MIM në zonën e shërbimit kundrejt atyre të tarifuara	83% (2022)	100%
OS4	**Ndërgjegjësimi i komunitetit me ndjenjën e pronësisë dhe përgjegjësisë për mbetjet që krijon, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të të gjitha grupeve komunitare.**	**4.1 Informimi dhe edukimi i qytetarëve**	1	Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese me qytetarët (nr/vit)	4	8
		4.2 Rritja e angazhimit të qytetarëve në aktivitetet e mbajtjes pastër të bashkisë	1	Fushata pastrimi te ndërmarra çdo vit nga bashkia me pjesëmarrjen e qytetarëve (nr/vit)	4	6
		4.3 Pjesëmarrja e publikut në proceset e vendimmarrjes lidhur me MIM	1	Planet dhe rregulloret e MIM të hartuara me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe bizneseve (%)		100%
OS5	**Parandalimi dhe reduktimi i mbetjeve në burim**	**5.1 Kompostimi i mbetjeve të biodegradueshme brenda oborreve në zonat rurale**	1	Numri i familjeve në zonat rurale që praktikojnë kompostimin në shtëpi	5%	30%
		5.2 Parandalimi i mbetjeve nëpërmjet ripërdorimit	1	Sasia e sendeve të përdorura që dhurohen (nr pako)		10
			2	Numri i personave që ofrojnë shërbime riparimi	10	10

Tabela 13 Kostot e parashikuara për realizimin e masave të Planit

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime operative	Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total		
M 1.1.1	Komunikimi dhe dakordësia me kryetarët e fshatrave dhe administratorët e Njësive Administrative		10,000		**10,000**	10,000	
M 1.1.2	Përgatitja e hartës për shërbimin e grumbullimit llogaritja e kostove për zonën e re të zgjeruar të shërbimit		-		**-**	-	
M 1.1.3	Llogaritja e kostove për zonën e re të zgjeruar të shërbimit		-		**-**	-	
M 1.1.4	Diskutimi dhe dakordësia për amendimin e kontratës së shërbimit të pastrimit me kompaninë private të shërbimit		-		**-**	-	
M 1.1.5	Miratimi i buxhetit të ri nga Këshilli Bashkiak		-		**-**	-	
M 1.1.6	Rishikimi i kontratës		-		**-**	-	
M 1.1.7	Shtrirja e shërbimeve në zonat e reja		500,000		**500,000**	500,000	
M 1.1.8	Gjetja e nje pike transferimi në fshatrat ku nuk ka shërbim: Tozhar, NJA Tërpan dhe Kapinovë, NJA Vërtop		20,000		**20,000**	20,000	
M 1.2.1	Vendimi i Këshillit Bashkiak për t'u bërë pjesë e një sistemi rajonal për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe për të pasur një Ndërmarrje të përbashkët me bashkitë e tjera		-		**-**	-	
M 1.2.2	Identifikimi i një vendi të përshtatshëm për stacion transferimi (ST)		25,000		**25,000**	25,000	
M 1.2.3	Projektimi i stacionit të transferimit			200,000	**200,000**	200,000	
M 1.2.4	Zhvillimi i konsultimeve publike për ST		50,000	50,000	**100,000**	100,000	
M 1.2.5	Aplikimi për leje mjedisore		100,000		**100,000**	100,000	
M 1.2.6	Aplikimi për leje infrastructure		-		**-**	-	

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime operative	Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total		
M 1.2.7	Ndjekja dhe monitorimi i ndërtimit të stacionit të transferimit		20,000		**20,000**	20,000	
M 1.2.8	Ndjekja dhe monitorimi i funksionimit të stacionit të transferimit		20,000		**20,000**	20,000	
M 1.2.9	Depozitimi i mbetjeve urbane në qendrën rajonale të menaxhimit të mbetjeve	200,000	500,000	200,000	**900,000**	900,000	
M 1.3.1	Përgatitja e projektit pilot për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të ricikluesshme të thata		20,000	20,000	**40,000**	40,000	
M 1.3.2	Miratimi i Kryetarit të Bashkisë		-		**-**	-	
M 1.3.3	Përfshirja e procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në kontratën e shërbimit me operatorin		-		**-**	-	
M 1.3.4	Zbatimi i projektit pilot për ndarjen e mbetjeve në qendrën e qytetit		200,000	300,000	**500,000**	150,000	350,000
M 1.3.5	Zbatimi i projektit pilot për ndarjen e mbetjeve në 3 shkolla		200,000	300,000	**500,000**	300,000	200,000
M 1.3.6	Caktimi dhe përshtatja e një vendi për magazinimin e përkohshëm të materialeve të ricikluesshme të grumbulluara		200,000		**200,000**		200,000
M 1.3.7	Blerje e 20 kontenierëve 1.1m^3 metalik, me kapak (10+10 me ngjyra të ndryshme)		650,000		**650,000**		650,000
M 1.3.8	Sistem grumbullimi i mbetjeve të thata të ricikluesshme në Fushë Peshtan		500,000		**500,000**	200,000	300,000
M 1.3.9	Fushatë ndërgjegjësuese me qytetarët për ndarjen e duhur sipas koshave në zonat pilot		200,000	300,000	**500,000**	500,000	
M 1.3.10	Aktivitete ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave		200,000	300,000	**500,000**	500,000	
M 1.4.1	Përgatitja e projektit pilot për grumbullimin dhe kompostimin e mbetjeve të gjelbra në Bregas, NJA Vërtop		20,000	20,000	**40,000**	40,000	
M 1.4.2	Miratimi i Kryetarit të Bashkisë		-		**-**	-	

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime operative	Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total		
M 1.4.3	Caktimi i tokës dhe përshtatja e terrenit për kompostim me sipërfaqe të mjaftueshme në një vend të përshtatshëm		150,000	250,000	**400,000**	250,000	150,000
M 1.4.4	Dakordësi për menaxhimin e pikës së kompostimit me fermerët, NJA dhe Kryetarin e fshatit		20,000		**20,000**	20,000	
M 1.4.5	Prokurimi i një makinerie grirëse për mbetjet e gjelbra të thata		200,000		**200,000**		200,000
M 1.4.6	Zbatimi i projektit pilot të kompostimit	100,000	100,000	100,000	**300,000**	300,000	
M 1.4.7	Fushatë ndërgjegjësuese me qytetarët për kompostimin e mbetjeve të gjelbra		50,000	150,000	**200,000**	200,000	
M 1.4.8	Aktivitete ndërgjegjësuese me nxënësit e shkollave për ndarjen në burim të mbetjeve të gjelbra dhe kompostimin		50,000	150,000	**200,000**	200,000	
M 1.5.1	Shtrirja e shërbimit në fshatra të tjerë që do të kenë infrastrukturën e duhur		500,000		**500,000**	500,000	
M 1.5.2	Përmirësimi i sistemit të monitorimit për zbatimin e shërbimit, duke rritur edhe pjesëmarrjen e banorëve nëpërmjet zyrës së informacionit dhe anketimit të banorëve		20,000		**20,000**	20,000	
M 1.6.1	Identifikimi i një vendi të përshtatshëm për depozitimin e mbetjeve inerte në afërsi të bizneseve të gurit		50,000		**50,000**	50,000	
M 1.6.2	Miratimi i Këshillit Bashkiak për vendin e përzgjedhur		-		**-**	-	
M 1.6.3	Studimi për funksionimin e vend depozitimit të mbetjeve inerte me makineri të posaçme për trajtimin e tyre, përfshirë llogaritjen e kostove		200,000		**200,000**	200,000	
M 1.6.4	Aplikimi për leje mjedisore		100,000		**100,000**	100,000	
M 1.6.5	Aplikimi për leje infrastrukture		-		**-**	-	
M 1.6.6	Funksionimi i vend depozitimit të ri të mbetjeve inerte		200,000		**200,000**	200,000	

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime operative	Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total		
M 1.6.7	Shfrytëzimi i materialeve inerte të rikuperuara			2,000,000	**2,000,000**		2,000,000
M 1.7.1	Caktimi i një sipërfaqeje të caktuar për mbetjet voluminoze dhe mbetjet elektrike/elektronike pranë një pike grumbullimi, aty ku ka hapësirë		20,000		**20,000**	20,000	
M 1.7.2	Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave për gjenerimin e mbetjeve voluminoze dhe elektrike/elektronike nëpërmjet një sondazhi me pyetësorë		-		**-**	-	
M 1.8.1	Përgatitja e konceptit për rehabilitimin e vend depozitimit			300,000	**300,000**	300,000	
M 1.8.2	Miratimi i konceptit nga Kryetari i Bashkisë		-		**-**	-	
M 1.8.3	Miratimi i buxhetit nga Këshilli Bashkiak		-		**-**	-	
M 1.8.4	Aplikimi per leje	100,000			**100,000**	100,000	
M 1.8.5	Zbatimi i masave rehabilituese			1,068,570	**1,068,570**	1,068,570	
M 1.9.1	Gjetja dhe aplikimi për financim		-		**-**	-	
M 1.9.2	Hartimi i konceptit për mbylljen e vend depozitimit në Plirëz pranë përroit			200,000	**200,000**	200,000	
M 1.9.3	Miratimi i Kryetarit të Bashkisë		-		**-**	-	
M 1.9.4	Aplikimi për leje		-			-	
M 1.9.5	Zbatimi i masave për mbylljen e vend depozitimit			1,000,000	**1,000,000**	1,000,000	
M 2.1.1	Krijimi i një njësie në bashki për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve për menaxhimin e mbetjeve		100,000		**100,000**		100,000
M 2.2.1	Organizimi i kualifikimeve për punonjësit e sektorit bashkiak për MIM		100,000	100,000	**200,000**	200,000	

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime operative	Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total		
M 2.2.2	Vizita studimore në bashki të tjera		100,000	200,000	**300,000**	300,000	
M 2.2.3	Pjesëmarrja në takime e seminare për menaxhimin e mbetjeve		100,000	200,000	**300,000**	300,000	
M 2.3.1	Hartimi dhe miratimi i Rregullores së përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve		20,000	100,000	**120,000**	120,000	
M 2.3.2	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e rrymave specifike		-		**-**	-	
M 2.3.3	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e mbetjeve inerte		-		**-**	-	
M 2.3.4	Forcimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve		-		**-**	-	
M 2.4.1	Krijimi dhe përditësimi i një baze të dhënash për dokumentimin, analizimin dhe raportimin e statistikave të mbetjeve në nivel bashkie		-		**-**	-	
M 2.4.2	Komunikimi periodik me Zyrën e Tatim Taksave dhe Zyrën e Informacionit		-		**-**	-	
M 3.1.1	Studimi i nivelit të tarifave për ndryshimin e tarifës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në bazë parimit "ndotësi paguan"		-		**-**	-	
M 3.1.2	Miratimi nga Këshilli Bashkiak		-		**-**	-	
M 3.2.1	Përfshirja e tarifës për menaxhimin e mbetjeve në faturën e tarifës së furnizimit me ujë		-		**-**	-	
M 3.2.2	Informimi i qytetarëve rreth kostove të shërbimit nëpërmjet takimeve në 3 NJA		50,000		**50,000**	50,000	
M 4.1.1	Fushatë informuese në media lokale		100,000	100,000	**200,000**	200,000	
M 4.1.2	Krijimi i posterave me mesazhe ndërgjegjësuese për mbajtjen pastër të mjedisit, përdorimin e koshave		100,000	200,000	**300,000**	300,000	
M 4.1.3	Krijimi i klubeve mjedisore në shkolla		-		**-**	-	

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime operative	Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total		
M 4.1.4	Fushatë ndërgjegjësuese me qytetarët rreth parandalimit të mbetjeve (mospërdorimin e qeseve plastike, enëve me një përdorim, ambalazheve të tepërta, etj.)		100,000	200,000	**300,000**	300,000	
M 4.2.1	Aktivitet me pjesëmarrjen e komunitetit për pastrimin e një zone të caktuar me rastin e Ditës Botërore të Tokës (22 Prill), Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit (5 Qershor)		100,000	100,000	**200,000**	200,000	
M 4.2.2	Aktivitet me pjesëmarrjen e komunitetit për pastrimin e një zone të caktuar me rastin e Ditës Botërore të Pastrimit (javën e tretë të Shtatorit)		100,000	100,000	**200,000**	200,000	
M 4.2.3	Aktivitet pastrimi me pjesëmarrjen e komunitetit në kuadër të fushatës "Të pastrojmë Shqipërinë" (muaji Nëntor)		50,000		**50,000**	50,000	
M 4.3.1	Zhvillimi i konsultimit publik për hartimin e dokumentit PVMIM		30,000	20,000	**50,000**	50,000	
M 4.3.2	Zhvillimi i konsultimit publik për hartimin e Rregullores bashkiake të menaxhimit të mbetjeve		30,000	20,000	**50,000**	50,000	
M 4.3.3	Zhvillimi i takimeve konsultuese me komunitetin dhe bizneset për hartimin e Rregullores bashkiake për menaxhimin e mbetjeve inerte		30,000	20,000	**50,000**	50,000	
M 4.3.4	Zhvillimi i takimeve konsultuese me komunitetin dhe bizneset për hartimin e Rregullores bashkiake për menaxhimin e rrymave të tjera specifike		30,000	20,000	**50,000**	50,000	
M 5.1.1	Takime me banorët e fshatrave rreth mbetjeve organike dhe procesit të kompostimit		20,000		**20,000**	20,000	
M 5.1.2	Identifikimi i banorëve që janë të interesuar të kryejnë kompostimin		20,000		**20,000**	20,000	
M 5.1.3	Prodhimi i 2 arkave për kompostim për shkollën e bashkuar, fshati Mbrakull dhe për shkollën e fshatit Tomorr i Madh		20,000	30,000	**50,000**		50,000
M 5.1.4	Monitorimi i procesit dhe promovimi i rezultateve		50,000	100,000	**150,000**	150,000	
M 5.1.5	Informimi i fermerëve mbi metodologjinë e kompostimit në shtëpi		30,000		**30,000**	30,000	

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime operative	Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total		
M 5.2.1	Grumbullimi i sendeve të përdorura (veshje, orendi, lodra, libra) në gjendje të mirë për t'u dhuruar tek familjet në nevojë		100,000		**100,000**	100,000	
M 5.2.2	Promovimi i çantave prej cohe të prodhuara nga veshjet e përdorura (xhinse), aktivitete në shkolla.			30,000	**30,000**	30,000	
M. 5.2.3	Promovimi i punës së shërbimeve të riparimit (këpucar, rrobaqepës, marangoz, elektroshtepiake, etj.)			30,000	**30,000**	30,000	
	TOTAL	400,000	6,475,000	8,478,570	15,353,570	11,153,570	4,200,000

5 Monitorimi

Monitorimi i Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është një kërkesë ligjore e përcaktuar në Nenin 12 të Ligjit nr. 10 463 dt. 22.9.2011, VKM nr. 687/ 2015, Udhëzimin nr. 6 datë 27.11.2007 të Ministrisë së Mjedisit, pika 19 dhe në Strategjinë Kombëtare. Ai lidhet ngushtë me dokumentimin e të dhënave dhe ndihmon për raportimet mbi shërbimet e kryera. Zbatimi i këtij PVMIM do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme në terren dhe duke shqyrtuar rezultatet kundrejt indikatorëve të Planit të përmbledhur në matricën e objektivave. Kjo paraqitje e planit bën të mundur vlerësimin sasior dhe cilësor të realizimit të tij. Monitorimi i ecurisë së Planit do të kryhet nga personi përgjegjës në Njësinë e Menaxhimit të Mbetjeve/ Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

5.1 Dokumentimi dhe raportimi

Në mënyrë periodike, do të përpilohet një raport vjetor mbi ecurinë e zbatimit të Planit. Sipas pikës 5, Neni 12 i Ligjit 10 463 për MIM, Bashkia Poliçan do të raportojë çdo vit në këshillin e qarkut të Beratit për zbatimin e Planit Vendor të MIM. Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave është një ndër masat e këtij plani (objektivi specifik 2.4).

5.2 Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të planit do të kryhet çdo vit si një praktikë standarde e njësisë përgjegjëse. Monitorimi do t'i lejojë administratës të shohë nëse masat po zbatohen në përputhje me planin dhe nëse rezultatet e arritura janë si ato të planifikuara. Nëse ka mangësi në zbatim duhet të merren në konsideratë mënyra të tjera për të arritur objektivat e planifikuara dhe Plani mund të rishikohet sipas nevojës.

Konkretisht, vlerësimi i planit do të fillojë me statusin e zbatimit të masave që e përbëjnë atë, duke evidentuar numrin e masave që janë zbatuar, atyre që janë në proces dhe masave që ende nuk janë zbatuar për vitin përkatës gjatë periudhës së planifikimit. Masat e vlerësuara në raport me të gjitha masat e planit do të shprehen me përqindje dhe mund të përdoren si referencë mesatare e zbatimit për nivelet e tjera, përkatësisht objektivat specifike dhe ato strategjike. Kështu për secilin objektiv mund të vlerësohet nëse përmbushja e tij është 1) në nivel mbi mesataren e përgjithshme të planit, 2) të paktën deri në 50% masa të zbatuara ose në proces dhe 3) në nivel të dobët. Pasi të përcaktohet statusi i zbatimit të secilës masë, do të ndërmerret një vlerësim i arritjes në nivel objektivash.

Nëse një masë specifike ende nuk ka filluar të zbatohet duhet të analizohen cilat janë arsyet për mosrealizimin apo çfarë pengesa janë hasur. Bazuar në këtë analizë do të merren vendime si mund të përmirësohet niveli i zbatimit të masave të veçanta dhe të Planit në tërësi. Ndërkohë që

objektivat dhe masat e përmbushura mund të tërheqin vëmendje për financim të mëtejshëm, sipas nevojës.

Qëllimi i këtij vlerësimi është sigurimi i informacionit të nevojshëm për të mbështetur, së pari, marrjen e vendimeve që do të përmirësojnë zbatimin e planit dhe së dyti, për planifikimin e buxhetit. Gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor të bashkisë, duhet të merren në konsideratë aktivitetet e parashikuara në matricën e Planit për vitin përkatës.

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve mund të rishikohet sa herë që konstatohet se është e nevojshme, por jo më vonë se 6 vjet sipas Ligjit për MIM. Në përfundim të periudhës së planifikimit që mbulon ky dokument, duke marrë parasysh ndryshimin e rrethanave dhe kushteve në bashki si dhe ecurinë e zbatimit gjatë periudhës së mëparshme, duhet të hartohet një Plan i ri Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve